

INTERVISTË ME JUSUF OSMANIN

Sllatinë | Data: 4 korrik, 2023

Kohëzgjatja: 133 minuta

Të pranishëm:

- Jusuf Osmani (i Intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Latra Demaçi (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Jusuf, nëse mundeni me na tregu diçka për kujtimet e juja ma t'hershme?

Jusuf Osmani: Po po filloj me, pak me biografinë time t'shkurtë, t'familjes, t'fshatit. Familja ime e ka prejardhjen nga trevat e Sanxhakut të Nishit, përkatësisht Kazasi, Prëkuples. E cila në fshatin Kojçiq, jo larg Prëkuples, ku në vitin 1877 në dimrin e ashpër '77-'78 janë dëbuar me dhunë nga vendlindja e tyre. Jo vetëm familja ime, t'partë e familjes time por edhe familje tjera t'cilat kanë jetu në 716 vendbanime të Sanxhakut të Nishit.

Janë dëbuar 250 mijë banorë, janë vrarë ose kanë pësuar nga të ftohti, acari rreth 70 mijë. Kryesisht të ri, pleq, jo t'ri po fëmijë, pleq por edhe t'ri. Kanë gjetur strehim në pjesë tjera të vilajetit të Kosovës, që ishte Kosova, Maqedonia, Lugina e Preshevës. Po shumë prej tyre kanë marrë rrugën edhe ma t'gjatë në trevat e Anadollit, në Turqi. E disa kanë arritur edhe në Siri, në Sham Damask. Familja ime është vendosur ktu, në këtë vendbanim Sllatinë e Madhe. Që ka qenë e banuar me popullatë çerkeze.

Çerkezët janë vendosë ktu në vitin 1862 edhe ata kanë qenë të dëbuar nga Kaukazi, Çerkeztani. Ku Cari rus i ka vra, i ka përsekutu dhe ata kanë gjetë strehim nëpër vise t'ndryshme të Perandorisë së atëhershme Osmane. E në Kosovë kanë qenë të vendosur në 30 vendbanime. Kshtu që ky vendbanim është pagëzu fillimisht me emrin Hajrie. Pastaj 1913-ten bëhet ndrimi i toponive dhe pagëzohet me emrin Sllatinë, duke u bazu në vendbanimin ma t'vjetër të afërt Sllatinë. Që ajo ka pasë numër ma t'vogël të banorëve është qujtë Sllatinë e Vogël, kjo Sllatinë e Madhe.

Ni popullatë që e vujtur, e përndjekur që ka arritë t'i mbijetoj të gjitha atyre vujtjeve, sulmeve barbare të pushtetit të atëhershëm serb. Ka vazhduar jetën sot në këtë vendbanim ku osht' një ndër vendbanimet më përparimtare në trevat e Kosovës. Pse po thom përparimtare? Për arsye se pas vitit 1945 ktu, ky fshat i ka pasë 25 mësues. Në atë kohë 25 mësues të cilët janë shpërnda nëpër treva të ndryshme të Kosovës dhe Drenicës dhe kanë arsimu popullatën e cila ka qenë mjerisht, pjesa dërmuese analfabetë. Pra, kontributi i fshatit osht' jashtëzakonisht i madh në ngritjen, në arsimimin e popullatës. Jo vetëm të ksaj treve por edhe të trevave tjera të Kosovës, sidomos të Drenicës.

Jeta ime. Unë fmi i fshatarit. Popullata ktu është marrë kryesisht me blegtori dhe bujqësi. I takoj ni familje mesatare që prindi im është marrë edhe nga pak me muratori dhe ka arritë që të rrisë ni familje të shëndoshë dhe të na shkolloj. Unë shkollën e kom kry... pak po dalim te kjo arsimimi im se është i lidhur me... tërë kohën ia kom kushtu msimit. Pse? Si e kom kry shkollën fillore, e kom kry në vendlindje. Pastaj, kam vazhduar Shkollën e Mesme Ekonomike në Prishtinë. Pas shkollës ekonomike në vitin 1967 ishte nevoja e madhe për msus në Kosovë. Ishte ekspazion i fëmijëve, kërkonte msus. Kam shku në Prizren dhe e kam kry rikualifikimin për msus. I kam dhanë tetë provime dhe diplomën dhe u bëra msus.

Hyra meniherë me ni fshat Magure kam punu dy vjet. Pastaj në Sllatinë. Po ndërkohë punoja, e regjistrova Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë, histori-geografi në Fakultetin Filozofik, atëherë filozofik, gjeografinë. Punoja, studioja në Gjakovë, studioja në Prishtinë. Të gjitha në afatin rekord i kam kry. Dy vjet e gjysë shkollën e lartë, katër vite fakultetin. Si diplomova n'fakultet prej ktuhit e lshova arsimin, shkova në Arkiv të Kosovës. Se kisha dëshirë edhe synimet e mi ishin që të merrej me veprimtari hulumtuese, kërkimore, shkencore. Në arkiv ishin kushtet ma t'mira dhe shkova u punësova në arkiv.

Në arkiv meniherë në specializim shtatë muj në Beograd. Gjashtë muj në Beograd kreva kursin e arkivistikës. Po ndërkohë u regjistrova në Zagreb në shkallë të tretë, gjeografinë shoqërore. Në '76-ten magjistrova. Meniherë në vitin '79 u regjistrova në Lublanë në doktoraturë. Atje osht' interesant si arrita të regjistrohem atje? Unë nuk kam ditë që është shpallë konkursi për doktorët e arkivistikës. Po në vitin 1978 ishte 100 vjetori i Lidhjes së Prizrenit. Unë si punëtor i arkivit edhe që u merrsha me këtë veprimtari hulumtuese, shkencore, e përgatita ekspozitën Lidhja Shqiptare Prizrenit me dokumente dhe fotografi.

Atë ekspozitë e hapëm në Prishtinë, pastaj në Sarajevë, Beograd, Novi Sad, Zagreb, Lublanë, në Shkup dhe në Podgoricë, atëherë u qunte Titograd. Kur e hapëm në Lublanë pasi u kry ajo ceremonia e hapjes, ishte akademik Pajazit Nushi, nënkryetar i Këshillit Ekzekutiv në hapje e qujshim *Preševnova dvorana*, kjo salla e Preshevnit, ni lokal impozant. U hap ekspozita dhe pati interesim shumë t'madh për Lidhjen e Prizrenit në Slloveni.

U kry ajo, na ftun me ni drekë në Brdo Kranje, ku elita shkonte atje. Mu kolegët e arkivit... kjo është kthesa ime e jetës. Kolegët e arkivit po m'thojnë, "Mos shko rri me ne se ne e kem përgatitë ni drekë modeste, na shoqnon, po kem qef me ty". Unë nuk shkova në atë dreken solemne, unë dola me kolegë. Gjatë bisedës po m'thojnë, "Jusuf na e kemi, është hapë dega e arkivistikës për studime të doktoraturës ktu", thashë, "Po nuk më pranoni mu si shqiptarë", thanë, "Jo, se na t'njofim", se u merrsha me shkrime, edhe tha, "tash vjen profesori i fakultetit", që ishte drejtor i Arkivit të Lublanës, ni Ivor Zhezhontar drejtor shkence. "Tash vjen edhe bisedojmë me të".

Erdhi ai, m'ka njoftë ai se n'seminare jemi pa në ish Jugosllavi. Tha, "Po Jusufin e pranojmë, pse jo. Por, duhet shefi i studimeve post universitare, ni akademik Vasilie Melik, ai", tha, "është përgjegjës". Vasilie e kishe vajzën, Milicën, aty. E i kanë thanë, "Shko thirrë babën le t'vjen". Kur dojnë me t'ndihmu. E kanë thirrë babën me telefon, atëherë s'ka pasë celular.

Erdh ai, po i thojnë, "Jusufin do ta regjistrojmë ktu", thotë, "Po vetëm duhet me gjetë mentorin". E dini ju çka është mentorin? Thanë, "Jo mentorin e kemi gjetë, profesor Zhontari", edhe m'pranunë mu. '79-ten. '80-ten kaloj nëpër ato strukturat administrative dhe fillova punën. M'duket rreth 15 u pranun nga tërë Jugosllavia në fakultet. Unë me marrëveshje me profesorin e mora temën, "Lëndë arkivore për kolonizimin dhe reformën agrare të Kosovës", '18, 1918-1941.

Se qëllimi i Serbisë ka qenë me pru kolon serb me kolonizu Kosovën, me ndrru strukturën e popullsisë shqiptare me i dëbu në Turqi, në Shqipëri. U lidh ajo konventa e '38-tes me Turqinë me i shpërngul 400 mijë shqiptarë. Kto vise me i kolonizu me sllav. Të bohet sllavizimi i Kosovës. Unë e mora atë temë. Se edhe arrita t'punoj deri në vitin 1985, '84-'85 dhe e dorëzova temën. Krejt dokumente arkivore, krejt. Si kanë ardhë, si kanë marrë tokën në emër të reformës agrare. E sidomos n'pjesën e Dukagjinit.

Pjesën e Dukagjinit ka pasë qëllim me ndërpre kontinuitetin e popullsisë shqiptare me Shqipërinë. T'vendosen sllavët atje. Ju kanë marrë tokë shqiptartë i kanë lanë pa... ka pasë që ia kanë marrë tërë tokën është përfshi në kompleksin agrar. Ka qenë e detyruar të punojnë tokën e vet që ia ka marrë sllavi. Se në Kosovë janë vendosë rreth 18 mijë, 17 mijë e 800 familje sllave, a rreth 70 mijë banorë. Unë me emra e mbiemra i kom paraqitë. Atë temë e kom botu mandej tri libra për kolonizim, reformë agrare dhe shpërngulje.

Domethonë ka qenë marrja e tokës, kinse reformë agrare, kolonizim me elementin sllav dhe shpërndarjen e shqiptarëve. Po Lufta e Dytë Botërore ndërpritet ma vonë edhe vazhdun. Ta përfundoj kta të shkollimit se kto punova shumë dhe arrita që ta mbroj i pari temën e doktoraturës në ish Jugosllavinë. Në atë fakultet dhe jam doktori i parë i arkivistikës në ish Jugosllavi. Në Kosovë nuk ka, nuk ka. E Jugosllavi ma vonë u hap në Zagreb, u hapën edhe do treva tjera.

Arrita që, ni sukses që për ni shqiptarë, për ni fshatar po e quj pa përvojë, gjuhën e msova, gjuhën sllovene por e kom përdorë gjuhën kroate ma shumë. Arrita në shkallën ma t'lartë akademike, domethonë doktor shkence. Prej ni fshatari deri n'shköllën, klasën e katërt t'shkollës ekonomikun jom shku me bagëti. I kom rujtë bagëtinë paradite, masdite me ni biçikletë jom shkue prej orës dy, një-dy, në Prishtinë i kom ndëgjju msimet. Natën jom kthy.

Ndonjë dimër i ashpër kur ka qenë, kom marrë një banesë me qira, kom jetu. Por bukën e merrsha veç t'hanën për dy ditë-tri e pastaj, pastaj visha t'mërkurën me shokë ose unë ose të tjerë edhe bukën e merrshim prej shpisë. Nuk ka pasë. Jo që s'kemi pasë po jom shkollu n'ato rrethana të një fshatari.

Edhe me krahasue që deri në klasën e katërt kur kemi shku në maturë unë kom shku në opanga të llastikut. S’e di a e dini? Opanga të Pirotit.

Jom shkue... kur shkojshim në mramje të maturës te romt në treg i kom ble ni palë kpucë t’vjetra. Domethonë, në shkollë, në klasë të katërt t’shkollës masi e krevat unë kom mathë kpucë. Krevatën nuk disha për herë t’parë aty do shokë ma vun se shkum... rroba blejshim nëpër treg. Se nuk e kanë ditë, menxi ke mbijetu, me bujqësi, me blegtori. Po e lidhi me atë, prej ni fshatari, ni bariu me punë arrihen të gjitha dhe kam arritë levelin [nivelin] ma t’lartë të studimeve. Pastaj kam vazhdu specializimet, kam qenë disa shtete...

Anita Susuri: Veç deshta me ju pytë se po...

Jusuf Osmani: Lirisht.

Anita Susuri: Po shkojmë prej temës n’temë. Ketë t’u folë për këtë punimin që thatë që keni bo, çfarë reagime ka pasë për atë punim të doktoraturës?

Jusuf Osmani: Mirë më pyte. Me profesorin kemi qenë t’kujdesshëm por kanë qenë vitet e ‘80-ta, 19... hulumtimet i kom fillu ‘80-ten, fillun ‘81-ten pak nacionalizmi serb pas demonstratave. Por fati se unë i njifsha të arkivave. Arkivi i Jugosllavisë ka qenë fondi i reformës agrare, kolonizimit. I njifsha ata kolegët edhe isha punëtor i arkivit, depërtoj shumë lehtë. Nuk kom pasë pengesa. Ma vonë nacionalizmi ‘89 e tjerë.

Domethonë... por profesori u kujdes mos me akuzu popullin. Për shembull pushtetin po, pushtetin serb e Mbretërinë Serbo-Kroate por mos me akuzu popullin. Aty t’kemi kujdes. Mandej ishte Partia Komuniste e Jugosllavisë. Me mbulu diçka, m’thonte, “Gjoje ndonjë dokument diçka të Partisë Komuniste që ta mbulon”, se Partia Komuniste ka qenë kundërshtarë e Partisë Radikale Serbe të Pashiqit. Edhe ata ndonjë dokument që kanë kundërshtu Reformën agrare.

Bile osht’ ni gazetë “Proleter”, që thotë, ni dokument i botuar thotë, tregon vrasjen, dhunën ndaj shqiptarëve. Qysh me i dëbu, thotë, “Kanë ardhë natën, ia kanë gjujt fishekt kanë kërsitë, ja u kanë gjujt fishekt në oborr. T’nesërmen kanë ardhë gjandarët e kanë bastis”, thotë, “ju i keni pasë kaçakët”. E dini, keni ndëgju çka janë kaçakët?

Anita Susuri: Po.

Jusuf Osmani: “E kanë keqtrajtu, ai s’ka pasë tjetër rrugëdalje dhe është shpërngulë”. E shkrun ni gazetë “Proleter” thotë, ni letër ka shkru ni prej Pejës edhe ai paraqet ankesat. Kanë qenë rivalitet politik se t’gjithë kanë pasë t’njejtin mendim. Domethonë, kemi qenë t’kujdesshëm se vitet e ‘80-ta mos me u paraqit tash por të vërtetën e kem paraqitë. Janë marrë toka, janë kolonizu, shqiptarë janë

shndërru në rob të tyre, ua kanë bajtë drutë, ua kanë punu arën, ua kanë ndërtu shtëpiat dhe kanë punu për ta.

Male ju kanë dhanë serbëve, ktu në Sllatinë iu kanë dhanë zabele. Shqiptartë s'kanë guxoftë me shku me marrë ni dru. U dashtë me shku me ia bajtë dy qerre dru kolonit që ia kishin dhanë kolonit falë edhe ni qerre për veti. Domethonë kto janë ato vujtjet që ne duhet m'i ditë. Jo vetëm kjo, por është në periudhën e mëhershme shqiptarët e Sanxhakut të Nishit që thashë. Krejt pasurinë e kanë lanë. Asgja s'kanë marrë, vetëm shpirtin në ni karrocë ose n'kamë kanë ikë me muj të tërë në dimrin e ashpër janë ardhë kanë gjetë strehim.

Na si studiues, se dikush po thotë jom shkencëtar, çfarë shkencëtari, shkencëtari duhet me shpik diçka. Studiues jom. Studiuesit duhet me plasu t'vërtetën. Opinioni botëror por edhe t'ritë sot në Kosovë e mos t'flasim për kto trevat tjera nuk është mirë informu për t'vërtetën. Pse? Se ne jemi shërby deri vonë me literaturën serbe. Ata na kanë paraqit t'ardhur. Ata na kanë paraqit si sulmues, agresor, vrasës, njeri me bisht. Sot po mundohen agresorin ta shndërrojnë në viktimë e viktimën në agresor.

Na duhet me shkru, me tregu opinionit botëror t'vërtetën, ta plasojmë t'vërtetën. Ata me rrena kanë shkru vepra të tëra. Për shembull, në Has osht' libri që e ka shkru ni Lutovac Hasi në Pashtrik, krejt i paraqet të ardhur. Ni Bajraktoroviç e ka shkru librin Metohija dhe Rugova. Ni tjetër e ka shkru për Kosovën, Urosheviqi, Kosovën, Moravën ni tjetër, mandej Kaçanikun.

Kanë vepra, vepra për Kosovë. Pse i kanë bo kto? Me i paraqit shqiptartë ozurpatorë, janë ardhë në Kosovë në shekullin e 15. Jo 15 po të 17 dhe i kanë zanë, i kanë përzanë serbët. Që nuk qëndron. Serbët kanë ardhë ktu, shqiptartë janë autokton. Jo vetëm ktu po edhe pjesën e Sanxhakut të Nishit. Kanë vujtë, nuk janë shkollu, ndoshta ju kanë tregu. Në periudhën, në kohën e Turqisë kanë qenë mejtepet¹, shkolla mejtepe, shkollë mejtep. Në '13-ten ndërpriten edhe ato dhe pushtohet nga serbët dhe malazezët trevat e Kosovës.

Ndërprehet çdo gjë. Ndrrohen toponimet. Juve duhet me ju interesu se duhet me i ditë toponimet. Meniherë në '13-ten [1913] Hanin e Elezit e pagëzojnë me Gjeneral Jankoviç që ka pre, ka vra. Obiliqi është qujtë Glloboder, e kanë bo Obiliq. Millosheva ka qenë ni katund Azizije e kanë bo Milloshevë. Ni katund Kolunist e kanë bo ksi, Tankosiç. Kanë ndrru emra e emra vetëm me zhdukë çdo element të gjuhës, traditës shqiptare.

Domethonë në kohën, n'atë kohë shkollat kanë qenë... në kohën e Austro-Hungarisë janë hapë do shkolla shqipe, 1915. Një ndër to është edhe një në Zym dhe në do vende në Prizren, shkolla e vajzave. Po ndërpriten ato, mandej prap vazhdon shkollimi, hapja e shkollave n'gjuhën serbe. Shqiptartë shumë pak janë përfshi n'ato vende ku kanë sjellë kolon. Pastaj '12-ten, 1941-shin msust vijnë prej Shqipërisë, hapen shkollat. Vazhdohet pas Luftës së Dytë Botërore. Organizon edhe kurse analfabetike.

¹ Shkollë fetare.

90 përqind e shqiptarëve kanë qenë analfabet. Analfabet s'kanë ditë shkrim, leximi. Kush e ka bo kta? Pushteti.

Mandej janë organizu kurset analfabetike. Duhet t'ja kushtoni ni komision, ni emision kurset analfabetike dhe si kanë shku edhe vajzat edhe mashkujt. Vajzat ma pak por... se kanë qenë t'ndara. Kurse shëndetësore, sidomos femrat mas luftës. Mandej edhe aty filloj nacionalizmi serb. Regjistrimi i shqiptarëve si turq, shpërnguljen e tjerë. N'shkollë, unë kom shku n'shkollë me ni libër, n'shkollë fillore. Abetaren n'klasë t'parë. Mandej ni fletore e përdorsha për t'gjitha landtë. As laps nuk kishim. E merrsha ata t'paraditës ia huazojsa lapsin.

Prindt jo që s'kishin po s'ishin aq shumë të interesun se s'kem pasë na traditë. Domethonë shkollën fillore me ni laps t'thjeshtë edhe ata shpesh e kom huazu me ni fletore. Librat u dufke kur e kryjke ni klasë dikush që ishte para meje, me shku me ia marrë librat e tina, me ia ble ose me m'i falë. Zakonisht i blejshim. T'njejtat libra me e shfrytëzu rastin. Po edhe s'ka pasë libra. S'po flas për plan programet që kanë qenë sllave.

Na msojshim histori, unë e kom pasë, lexoj historinë thotë shqiptartë e kanë prejardhjen prej sllavëve. E kanë përkthi, nuk i kanë përmend ilirët. Ma vonë kto. Prej viteve kur bohen ato, '48, demonstratat '69 ndryshimet kushtetare bohen disa ndryshime. Pra, n'shkollë të mesme gjysën e lëndëve i kena pasë serbisht. Ma vonë, protestë daktilografi që shkrun me makinë i ngelte nxansat. Prej tri paraleleve, ni paralele arrinte maturën. Nuk po di serbisht. Ku ka me ditë serbisht i katunit, ni katun osht' Graboc, Mjekiq kanë qenë s'dishin asni fjalë.

T'gjithë i ngeli kjo profesoresha e serbishtës. Ia hupi vitin. Domethonë, mu rusisht, msojshim rusisht. Donte me më ngelë ajo. Unë mso përmendësh. Thojke, "S'po e shqipton mirë Moskva", thojke, "Moskva", m'kujtohet mirë. Unë ku e di theksin. Vetëm pretekst me të ngelë atëherë i thojshin. Po kom arritë qysh kom arritë dhe, edhe me punë, me punë. Se nuk ka qenë lehtë me punu.

Katër fmi i kom, tre janë në Londër gjatë luftës kanë mbetë, njo e kom ktu. Me rritë fminë, familjen, me pru n'familje. Kto shpija jeme në 1999-ten osht' djegë ktu ku jeni, osht' djegë në tërësi. Kam pasë me, rreth tre mijë libra, rreth 50 kutija me dokumente. Kur i kanë pa kanë hy edhe ma kanë djegë këtë shpi teme edhe krejt dokumentacionin. Kanë ardhë në Prishtinë me më gjetë me më marrë po unë kom ikë, fati. Janë shku n'mal, n'katun m'kanë lypë por fati, ymri, kom arritë të mbijetoj.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Deshta me ju kthy, ju jeni '48 edhe keni qenë ndoshta fmi dhjetë vjeçar ose 12 vjeçar në periudhën e Rankoviçit...

Jusuf Osmani: Po.

Anita Susuri: Që ka qenë kohë shumë e vështirë. A keni ndonjë kujtim prej kësaj kohe?

Jusuf Osmani: Po kom, kom kujtim. Fmi. Ish dimri i vitit 1956, aksioni i mbledhjes së armëve. Armët që s'ka posedu popullata. Po ka qenë pretekst, presion, dhunë me i dëbu shqiptarë në Turqi. Atëherë pjesa dërmuese e shqiptarëve janë shpërngulë në Turqi. Unë si fmi dilshim, i thojshim, *ulicë* [srb.: rrugë], para xhamisë ni hapësirë. U tubojshim. S'kishim televizor, s'kishim radio, s'kishim kurgjo. Vetëm fmija lozsshum edhe tregojshin në shkollë kanë ardhë kta milict me, atëherë është qujtë milicia, me kta përfaqësuesit e pushtetit dhe po i thirrin popullin m'i dorëzu armët, kryefamiljarët. Babën tem e kanë thirrë, kanë thanë, "Bire armën", ka thanë ni kojshi e kena pasë malazez thotë, "Thuj që ta bi nesër, ta bi", shpëton nuk e rrafin. Ka shkue në Serbi e ka ble ni pushkë, e ka ble pushkën edhe ia ka dorëzu...

Anita Susuri: Baba juj?

Jusuf Osmani: Baba im. Domethanë në Serbi. Kanë shku njerëzit, i kanë dorëzu pushkën dhe ose revolën. Xhanari, ai polici ia ka shitë tjetrit. E ka ble ni pushkë ka shku nëpër dorë të disave, se kanë përfitu ata. E kanë shitë pushkën edhe ai u dashtë me dorëzu pushkën për mos me rraf. Ni kojshi e kom pa vet me sytë e mi, t'u ardhë, ka punue, ka punue në Minierën e Magurës, magnezitit, vjen prej ndrrimit të tretë, n'kamë shtatë kilometra osht', me llampë të karabitit. Ju s'i dini ato llampa, janë do llampa bojnë dritë me karabit osht', ni lloj guri. Me to në krah edhe e ka pasë ata shlemin.

Vjen te shkolla, hyn, jo hyn po t'u kalu dalin xhanarët. "Ty po t'kërkojmë". Ai pa ditë kurgjo hiç e fusin aty, e rrahin ata dhe disa tjerë aq shumë saqë e kom pa vet. Borë, nuk mundte me ecë. Shkonte, u rrxonte edhe me durë e kamë. Që aq shumë e kishin rraf. Pa kurfar' faji. Veç që u kthy prej punës i kanë thanë, "Ti ki armë", edhe e kanë rraf. Menzi ka shku n'shpi. Nuk guxoishin njerëzit as me dalë me ndihmu. Se kanë psu pse po i ndihmon ti që është kundër shtetit, armik i shtetit, armik i popullit. Domethonë vet i kom përjetu kta të grumbullimit t'armëve. Kom ndëgjue pak ma herët ka qenë, kjo, grumbullimi i tepricave. Edhe kjo është ni temë shumë interesant. Ua kanë marrë krejt drithin edhe magjet ia kanë fshi me...

Anita Susuri: Kjo mas Luftës së Dytë apo?

Jusuf Osmani: '53-'54, qaty. Ia kanë marrë tërë pasurinë edhe vetë edhe pulat edhe mishin, drithin edhe kinse teprica. Që populli i varfur ku ka pasë teprica. Ashtu i varfun ia kanë marrë tërë pasurinë. Nëse nuk e ka dorëzu atë pasuri, atë çka e kanë kërku, e kanë keqtrajtu. Ia kanë konfisku edhe pasurinë. Konfiskim se nuk e ke dorëzu, i kanë thanë vishak, tepricë. Po e thom tepricë n'thojza se s'ka pasë teprica. Domethanë është ni temë, unë s'e kom përjetu, nuk e mbaj mend.

Po ni kohë e mbaj pak mend po veç ka qenë fundi. Ka qenë ni kohë kur e kanë qujtë kolektivizmi, a ju kanë tregu dikush? Në Rusi kanë qenë sovkhözët dhe kolkhozët², në sistemin rus. Me i marrë krejt tokën, m'i shti banorët e Kosovës kolektiv e me jetu me punu bashkë. Disa nuk kanë pranë. Po ata i kanë konsideru armiq t'popullit. Ata që kanë hy kanë psu se kolektivi s'punon. Kush ta punon tokën? Kanë punu me ata që s'kanë pasë tokë, s'kanë pasë traditë.

Ktu në Sllatinë ka qenë ndërtesa e kolektivit i thojshin. Kolektivit, ku janë tubu ato t'mirat materiale dhe i kanë shpërnda. Populli ka punue vetëm për ni kafshatë t'bukës, kurgjo tjetër. Sikur në Shqipëri që ka qenë ni kohë t'gjatë edhe kto kanë qenë ni periudhë. Pastaj, kom përjetu përndjekjet e intelektualëve shqiptarë. Në shënjestër kanë qenë msust e Sllatinës. Ka qenë intelektualit për m'i burgosë edhe m'i keqtrajtu mandej edhe m'i vra.

Ka pasë raste e kanë marrë msusin, atdhetarin dhe e kanë çu n'kufi e kanë vra. T'nesërit kanë thanë, ky ka dashtë me ikë, me ikë edhe roja kufitare e ka vra. Vet e kanë çu. Ktu në Sllatinë, thashë, 25 msus të shpërndarë. Kanë qenë të përndjekur por t'bashkuar. Ni fshat osht' i joni që kurrë askush askënd s'e ka akuzu. Nuk kanë gjetë bashkëpunëtor, bashkëpunëtor. Se për me realizu ni, kanë pagu njerëz, shqiptarë. Madje shqiptarë i kanë vra krejt intelektualët. Hasan Prishtinën, Haxhi Zekën, Nazim Gafurrin e tjerë, shqiptarë. Se kanë pagu me pare.

Ktu te na kanë shpëtu falë unitetit. Kanë qenë disa t'burgosur por n'periudhë me krahasu me tjetër ma pak. Se e kanë rujtë njani tjetrin në momentet ma t'vështira. Po janë këto ngjarje. Tjetër çka mbaj në mend. Këtë aeroportin që po e shihni, unë i kom rujtë bagëtinë aty. Ka qenë lluga, lluga. A e din çka i thojnë lluga? Mal i vogël, fushë, llugë i thojnë. Aty gjojshim na lepuj, fllanza si fmi. Shkojshim i rujsim bagëtinë. Mandej erdhën e matën dhe fillun me ndërtu.

Unë për herë t'parë e kom pa televizorin unë në kazermë se erdhën edhe ushtarë. E kom pa televizorin, si fmi ishim. Me thanë nja shtatë-tetë vjet, dhjetë. I shihshim aty ushtartë t'u e kqyrë. Ni ushtarë thotë, "A po don me pa?" Na shtin me pa televizorin. Për herë t'parë. N'katun rrymë s'ka pasë. Unë jom shkollu ni kohë t'gjatë me llampë vaj gurit. Ktu llampën e vaj gurit edhe t'u shkru, t'u lexu. Ma vonë ka ardhë rryma. Fshati ka qenë plot lloq, baltë. Nuk kemi qenë aq shumë t'vetëdijshëm për m'u organizu, me shtru me gur, me... pak m'u kujdesë për infrastrukturën.

Por edhe bagëtia, lëvizjet e kanë shkatërru. Ma vonë u vetëdijësun. Me krahasu me fshatrat tjera, ktu e kem pasë shtëpinë e kulturës edhe u hapë biblioteka. Na sollën ni televizor. Unë merrsha në bibliotekë libra, lexojsha. Isha i pasionuar me lexu. Sepse nuk kishim ku me marrë. T'jepte literaturë profesori e atëherë ka qenë ni regjim shumë ma i ashpër, jo vetëm në arsim por edhe në sjellje, në respekt.

² Një formë e fermës kolektive në Bashkimin Sovjetik. Kolkhozët ekzistonin së bashku me fermat shtetërore sikur sovkhözët. Këto ishin dy komponentët e sektorit të socializuar të fermave që filluan të shfaqen në bujqësinë sovjetike pas Revolucionit të Tetorit të vitit 1917, si një antitezë ndaj strukturës feudale të skllavërisë së varfër dhe pronarëve aristokratë dhe për bujqësinë individuale ose familjare.

Msusin kur e kom pa msusin tim n'rrugë jom ikë, mos me u taku me të. Ju tash p'e dini, bojnë hajgare shoqnohen. Unë kom ikë prej msusit tim. Msusi im për mu ka qenë zot. Thojsha, a han bukë msusi? Qaq ka qenë msusi i respektun. E sot po e shihni, krahasoni kto. Aeroporti... mandej fillun rrugën, na lshun autobusin. Vitin e katërt deri në Fushë Kosovë udhëtojsha me autobus, me tren deri në Bellaqevc. N'kamë, dikur vonë u lshu autobusi, s'kishim.

Në Pejë deri në vitet e '70-ta për me shku në Pejë s'ka pasë rrugë ktu. Ose në Gjakovë. Me shku në Pejë me automobil u dashtë për Mitrovicë. Me shku në Gjakovë me automobil, që ka pasë pak, u dashtë me shku në Prizren prej Prizrenit në Gjakovë. Kjo rruga osht' vonë. Domethanë, infrastruktura ka qenë në nivel shumë t'ultë. Kanë shku njerëzit me qerre. Kto, n'këtë fshat në Sllatinë kanë ardhë shumë, shumë mysafir. Pse mysafir? Drenica, kjo Anadrina, Llapusha kanë bo tregti me bagëti edhe kanë shku n'treg në Prishtinë. Tregu në Prishtinë ka qenë ditë e marte.

Unë e maj mend, me bagëti e me qerre, vishin ktu bujshin ni natë t'nesrit në mëngjes me shkue n'treg me i shitë. Për shembull, rrush ajo pjesa e Rahovecit, dardha, kto gjëra, kto pemë. Me ato blejshin, blejshin dridhna, gjëra t'nevojshme për shtëpi. Cilat kanë qenë ato elementaret për shtëpi, ndoshta ju kanë tregu. Ka qenë bezi, me maru kmisha, se leshin i kanë bo teshat prej leshit vet. Kanë ble vaj guri për me bo dritë, ka qenë peshkvja. Çka osht' peshkvja? Qerret kanë qenë prej drunit. U dashtë me lye ato te rrota me peshkve që ajo t'u lëvizë ka krijue dhe u djegë. E me peshkve... peshve, vaj guri, na pak sheqer edhe kafe.

Sheqer e kafe vetëm ato familjet me zo. Sheqer për netë t'mdhaja, e dini, për katragjegja, për bajram e tjerë. Nuk kanë pasë sheqer. Shumë familje me mjaltë e kanë bo hallven ose kanë shkue prindi ka ble sheqer. Na u gzojshim, e pritshim n'rrugë me ardhë baba me na pru naj bonbon, do laramana kanë qenë, i punojshin prej sheqerit. U gzojshim me ta dhanë ni bonbon. Se s'kish. Ka shku n'shehër baba na bjen bonbona. Domethanë kto vishin prej trevave të tjera, bujshin ni natë edhe shkojshin n'treg. Se nuk ka mujtë ai me mrri prej Rahovecit, atyne pjesve të Drenicës me mrri. Ju ka dashtë gati ni ditë me shku, gjysë dite. Ka ardhë ka pushu, e ka ushqye, ka ushqyer bagëtinë edhe t'nesrit ka shku n'treg. Domethanë vend pushimi edhe vend strehimi, m'u strehu për me shku t'nesrit me bo tregti...

Anita Susuri: E a ka pasë që kanë shku te familjartë apo si? Ka pasë naj han a?

Jusuf Osmani: Jo nëpër familje, s'ka pasë hon ktu. Ni hon ka qenë, shitore i kanë thanë hon, e vogël. Kanë ble qito gjërat që i përmenda. N'familje. Po kanë qenë shumë solidar. Sot me t'ardhë ni mysafir po mrrolet reja, nusja. Atje ka ardhë... unë e di, thojshin për ni familje tërë oborri ju ka mbushë bagëti që kanë ardhë. I ka pasë secila, jo secila po shumica, odat. Odat te dera e oborrit dhe kanë flejt në oda. Në oda ju kanë çu ushqim. Bile thojnë ditën e marte kanë shti pasul, a e keni ndëgjju kta?

Anita Susuri: Jo.

Jusuf Osmani: Për shembull, familja jeme gjellë ka shti pasul. Pse? Vijnë tjetër edhe me i ushqy. Pasuli ka qenë ma lehtë m'u përgatitë edhe m'i ushqy. Atëherë ju kanë dhanë bukë, bukë të kallamoqit, s'ka pasë bukë të grytë. Unë jom rritë, shkojsha me lopë, me bagëti nana ma jepke ni copë bukë të misrit edhe ni copë djath edhe n'strajcë, e shtisha n'strajcë edhe ton ditën nëpër mal, nëpër fusha i rujsa bagëtinë. Atëherë kur kanë ardhë mysafirët ktu me shumicë kanë shti pasul. Se vijnë. Se tash me shti gjellë tjetër, ajo pak. E kanë mush ni, ni, i kanë thanë veksh³. Veksh pasul. Sikur... vekshi i madh edhe kanë zi pasul, bukë t'misrit edhe i kanë shërby se s'kanë pasë. Edhe kanë fletë aty t'nesrit kanë shku n'treg...

Anita Susuri: A po ju kujtohet te ju që ka ardhë naj kush?

Jusuf Osmani: Po, po. Kem pasë... unë pak ma vonë, sidomos i kem pasë do të Astrozubit vishin. Astrozubi është te Rahoveci, Malisheva. Ata vishin rregullisht rrush bishin edhe dardha. Ktu rrush s'ka pasë, dardha pemë, kto vonë janë pemtë te na. Thojshin s'bohen. Bishin pemë e ndrojshin me drith, e ndrojshim me drith. E ata rregullisht vishin te ne. Bile m'kujtohet si fmi, njani u smu, baba e ka pasë lshue në ksi, në spital e kish pasë zorrën qorre dhe shpëtoi. Kanë pasë familje, mandej u lidhën familjet. Në masë të madhe ka qenë... ma herët kur kanë shku n'treg s'ka pasë komunikacion. Mjeti i komunikacionit, ata t'pasurit e kanë pasë qejzen. A e din çka osht' qejza?

Anita Susuri: Ksi si me kerr e me kali diçka?

Jusuf Osmani: Ni kali edhe ni pjesë e qerres me dy rrotë edhe me to kanë shku. N'qytete kanë qenë pajtonat, pajtonat. I keni pa në Prizren tash po del ni pajton, pajtonat. E qerre kanë ardhë edhe me qerre të drunit, me kije, me bujë, kuaj rrallë se s'kanë pasë. Shkojshin n'treg. Për atë ajo peshkve ju ka nevojitë me i ly rrotën që mos me u djegë, mos me u dëmtu. Solidariteti ka qenë në nivel shumë ma t'lartë se që është sot. Edhe me t'panjohurit. Ka ardhë ka trokit n'derë edhe i ka thanë, "Byrëm". Mos t'koftë kanë as ni mashkull aty, e zoja e shpisë, plaka i ka thanë, "Hyn n'odë", oda ka qenë, dera e odës përherë e hapur, "hyn aty pusho deri t'vijnë burrat". Nëse ka qenë nodnjë plakë kshtu ia ka çu do ujë, e ka shërby me bukë. I panjohur, i panjohur.

Jo tash, "Kush osht'? S'janë burrat ktu, s'kem vend". Atëherë e ke pasë odën për mysafir. Se mysafiri ka qenë i shejtë, "Mirë se t'ka pru zoti", edhe ka hy aty. I ke qit' çka ke pasë. Mandej odat kanë luftë rolin, kanë qenë jo vetëm të kuvendit ku janë mbajtë tubime e kto, po kanë qenë vend ku kanë pritë mysafir. Se kto gjana t'reja që ju thashë, kto, ardhjen prej Drenicës, jo vetëm ktu te na po edhe fshatra tjera të rrethinës të Prishtinës... ose në Prizren kur kanë shku prej viseve tjera me bo tregtinë në Pejë ashtu kanë bujtë te ndonjë familje. Mandej kanë kriju miqësi.

Unë e mbaj mend ata të Rahovecit të Astrozubit vinin rregullisht te na. Kanë pasë tjetër po ashtu. Ke kriju miqësi familjare. Ma vonë edhe kom dëgju edhe martesë kanë bo, martesë. Po ashtu edhe në

³ Enë nga balta.

luftën e fundit ka pasë shumë refugjatë ktu, shumë refugjatë. Po ndodhën do ngjarje ikën. Se ktu aeroporti afër, ushtria serbe afër dhe ikën. Janë kujdesë, u dashtë kujdesë. Ktu s'ka guxu me u hapë front. Për arsye se je sulmue. Por kanë pasë shumë refugjatë edhe kanë lëvizë prej Drenice, prej Dukagjinit kanë ardhë në Sllatinë natën, janë vendosë, edhe natën ose n'forma t'ndryshme i kanë përcjellë për Prishtinë. Ka ardhë autobusi, t'u mendu se janë vendas, se ka pasë punkte. Te na tradita ka vazhdu edhe ka qenë në nivel edhe gjatë luftës, solidariteti, por edhe atëherë. Unë i kom përjetu edhe njënen edhe tjetrën.

Anita Susuri: E kur ka qenë hera e parë që ju keni udhëtu jashtë fshatit edhe qysh, qysh keni arritë për shembull në Prishtinë?

Jusuf Osmani: Po, qe, për herë t'parë, për herë t'parë kur kom shku n'treg në Prishtinë kom qenë i vogël, i vogël. Më merrte baba, shkojshim n'treg me qerre t'kive, kijtë e dini ju çka janë? Qej, kuaj vonë kemi bo. Më merrte ose me i ngreh kijet ose me ju grah. Gëzimi ma i madh kur shkojsha në Prishtinë. I kisha shtatë-tetë vjet, dhjetë vjet. Atje u gzojsha se m'blente bonbona, m'blente bukë, bukë t'gryt na i thojshim n'furrë. Ta bëlente ni copë n'furrë. Se kanë pasë hasjanët atëherë kanë pasë hapë furra në Prishtinë. Gëzimi ma i madh kur kom shkue për herë t'parë me babën n'treg. Qeni tanë kohën, qeni i shpise vinte deri në Prishtinë na përcillte. U kthente, kur vishim e gjejshim qenin n'shpi. Me qen kom pasë përvojë, jo përvojë por si bari m'hupshin loptë. A thoni ju bagëtitë, loptë?

Anita Susuri: Po, po.

Jusuf Osmani: M'hupshin edhe s'guxojsha me ardhë n'shpi pa i gjetë. Me qen unë natën nëpër mal, vet, t'u i lypë loptë derisa i gjejsha i bijsha n'shpi. Pastaj, jom shkue ma vonë, niherë n'shkollë fillore në ekskurzion na çun msust në muze atje me pa. E mandej në shkollë të mesme u regjistrova...

Anita Susuri: Cilën shkollë keni shku?

Jusuf Osmani: Shkollën Ekonomike, Shkollë Ekonomike, por udhëtoja, udhëtoja. N'kamë deri në Fushë Kosovë ose me biçikletë ose me tren. Osht' ni Bardhi shkon për Pejë.

Anita Susuri: Ku ka qenë atëherë Shkolla Ekonomike?

Jusuf Osmani: Shkolla Ekonomike ku osht' Katedrala sot.

Anita Susuri: Ajo ndërtesa a?

Jusuf Osmani: Vitin e parë e kom kry në gjimnaz, në gjimnaz. Mandej u transferum, ajo, shkollë ni kohë edhe gjimnaz ka qenë...

Anita Susuri: Gjijn Gazulli.

Jusuf Osmani: Po, jo Gjijn Gazulli, se ndryshe osht' qajtë. Është qajtë gjimnazi i dytë, Xhevdet Doda. Aty kom kry. Mandej u rrënu, e dini ju. Ku është katedrala qaty tri vjet i kom kry. Në fakultet shkojsha kohë pas kohe se punojsha, punojsha. Në Gjakovë organizojshin seminarët verore. Tre muj gjatë verës shkojsha i ndëgjojsha ligjeratat n'shköllë t'lartë. Kshuqë kurrë, kurrë nuk kom qenë i lirë. Unë mendoj... për herë t'parë jom shku n'deti n'vitin '70-të me ferialist si student, si student. Organizojshin Lidhja Ferialiste, edhe ata me pytë babën, "A t'shkoj?" Edhe isha i punësun, i punësun.

Kom punu tërë rrogën, pagën ia kom dorëzu babës. Ka qenë traditë. Sot grua s'ia dorëzon burrit. Atëherë na krejt vllaznia ia kena dorëzu babës rrogën me zarfë, kufer. U dufke me pytë babën, me ia lypë paret tua që i kishe fitu edhe me shku. Nuk ka qenë sikur përpara. Ka pasë diciplinë, po ka pasë respekt. Respekt te prindi. Patëm shkue në Omish, m'kujtohet në Mal të Zi, atje në Kroaci. Knaqësia ma e madhe me shokë, studenta. Kish edhe viseve të tjera. Unë e njifsha nga pak, e pata mësu serbishtën e njifsha jo aq po komunikojsha. Se kish do t'katuneve nuk dishin hiç, s'kishin pasë kontakte.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Deshta me ju pytë edhe për Prishtinën e qasaj kohe edhe qat' shkollën që s'ekziston ma. Qysh ju është dokë juve?

Jusuf Osmani: Po kur kom shku për herë t'parë në Prishtinë, atë shkollën që e përmendi ku osht' Fakulteti Filozofik kanë qenë kazerma ushtarake. Krejt hapësirë. S'ka pasë fakultet aty. Ky ku osht' universiteti, kanë qenë do ndërtesa thojshin janë të ktyne, të vjetra të oficerëve, të oficerëve. S'kam hy n'to veç i kom pasë pa. Prishtina ni rrugë ka qenë. Rruga kryesore sot Nanë Tereza, dy anë kalojshin automobila rrallë edhe do fiqa. Fiqa, a e dini çka janë fiqat? T'vogla kanë qenë. Kur hypshe në Veternik, veç ni ndërtesë e ke pa ka qenë spitali. Krejt ka qenë... s'ka pasë Ulpianë, s'ka pasë Dardani. Fillonte aty ku osht' Fakulteti Filozofik do shtëpia edhe s'ka pasë, kto janë t'vona...

Anita Susuri: Po faktikisht thojnë që qyteti ka qenë deri aty te shkolla që e përmenet ju ma tutje...

Jusuf Osmani: Po. Po aty.

Anita Susuri: Deri në Pejton aty.

Jusuf Osmani: Deri në Pejton. Në Pejton e mbaj mend kanë qenë do rrënoja të ni mulliri t'vjetër t'rrymës i Shyqeri Begut i thojshin. Nuk e kom mrri aty veç thojshin, ktu ka qenë, ku osht' Grandi sot Mullini i Shyqeri Begut aty. Kto shpijat kanë qenë, kto ndërtesat, ku osht' Ministria e Kulturës ktu janë

po. Mandej atje, te gjimnazi ku osht' muzeu, unë e kom përjetue pak si i vogël kur kom shku u rrënojshin shtëpitë. Ku osht' Prishtina e vjetër sot.

Anita Susuri: Ka qenë ni pazar...

Jusuf Osmani: Po ka qenë aty ku osht', ku osht' televizioni edhe sot po ka qenë edhe aty një treg i mbuluar.

Anita Susuri: Po.

Jusuf Osmani: I mbuluar. Po e kanë rrënu. I kanë rrënu ndërtesat e vjetra, vitet e '50-ta, pse? Ka qenë m'i hupë gjurmët orientale shqiptare. Identitetin musliman shqiptaro-turk me e shkatërru. Në... komunistat e përhapën ni parollë, "Ta rrënojmë të vjetrën, ta ndërtojmë të renë". Kjo ka qenë parollë. Fillun t'i rrënojnë objektet e vjetra. S'pari ku osht' sot Qeveria e Kosovës ka qenë qarshi e mbuluar sikurse në Kapali Qarshi në Turqi. Ka pasë shumë objekte. Objekte t'vjetra arqitektonike orientale. E kanë rrënu edhe xhaminë para teatrit, ka qenë. Kinse po ndërtojmë të reja. Por qëllimi ka qenë tjetër. Unë i mbaj mend pak ato...

Anita Susuri: Xhaminë a e mbani n'mend?

Jusuf Osmani: Jo nuk e mbaj mend veç e kom n'fotografi. Se ajo m'duket kur kom lind unë mos koftë rrënu. A kto, aty, ku osht' korza, ku osht' i Skënderbeut, sot monumenti i Skënderbeut përmendorja ka qenë dy rrugë shkojshin. Njëna anej kah gjimnazi tjetra u lshonte te poshtë edhe aty u bonte nifar' lloj korze e parë, dilshin. M'kujtohet si fmi serbët vishin prej katuneve, serbët prej katunit, femrat serbe. Na u çuditshim pse po vijnë. Po na tregojnë se po vijnë m'u njoftu me djel. Djemtë vishin, djemtë e katuneve, serbe po mendoj, m'u pa edhe aty u njoftojshin.

Te na shqiptartë s'ka pasë, e dini ju me msitni me kto. Qat' korzën e serbëve e mbaj mend. Vishin serbët t'martëve zakonisht, u veshqin edhe dilshin me ato veshjet. I kanë pasë do opanga me tureçka. E i shifsha ata, si fmi. Lokale ka pasë pak po Prishtinën, Prishtinën e vjetër me ua përshkru, se ka qenë mahalla e Muhaxherëve, 1878 kanë ardhë muhaxherët janë vendosë aty. Ni kohë kanë qenë të izoluar sepse i kanë qujtë t'ardhur, ardhacak e lëje më muhaxher.

Unë jom marrë me këtë studim edhe i kam shkru kto librat {i tregon librat mrapa}. Shtatë janë për muhaxherët. Prishtina, sot, e mbaj mend edhe lumin kur u mbulu i Prishtinës. Ura ka qenë, ku osht' teatri, aty kalon lumi, urë e drunit ka qenë. Unë vet e mbaj mend. Mandej filloj të mbulohet. Vellusha ka qenë lumi Vellusha edhe ai tjetri, qysh e ka pasë atje te tregu, s'po m'kujtohet. Qito dy lumenjë. Po fillun me gjujtë berllog e i mbulun. Nuk i mirëmbajshin.

Anita Susuri: E kшту sa i përket jetës kulturore, për shembull me shku në kinema ose në teatër me lëvizë, sa e keni...

Jusuf Osmani: Po, po, po. Po gëzimi ma i madh ka qenë kur si nxanës, në të vërtetë, në shkollë fillore e kem pasë na ktu shtëpinë e kulturës. Bijshin filma, kuptohet serbisht. Nuk i kuptojshim. Shkojshim afër atyne edhe na i përkthejshin. Domethonë gëzimi ma i madh ka qenë kur vinte filmi. S’kem pasë tjetër argëtim. Mandej si nxanës, mas msimit, ose kur ish, u tubojshim hajde po shkojmë n’kino. Ka qenë Kino Vllaznimi, Kino Rinia.

Aty shkojshim edhe jeta kulturore ktu në fshat organizojshin, shkolla organizonte. Unë si fmi e mbaj mend shfaqje nxanësit. Unë kom recitu vet, kom dalë kom recitu vjershtë para publikut si nxanës i klasës së shtatë. Kom dalë. Tjertë, vajzat me dimija vallëzojshin, valle dasmash p’e dini ju. T’ritë këndojshin me çifteli e kto. Vishin edhe prej Prishtinës shoqëri tjera se e kishim na shtëpinë e kulturës. Po tjetër argëtim s’kem pasë. Serbët e mbaj mend organizojshin t’shtuneve po nuk shkojshim ksi me disqe kanë qenë kto, disqet e dini...

Anita Susuri: Ballo a?

Jusuf Osmani: Po, si ballo. Shkojshin edhe do shqiptarë u tubojshin po unë isha fmi, nuk shkojsha. Kto kanë qenë pak në nivel. Me sport jam marrë. Ka qenë fusha e sportit edhe u organizojshin turnire. Kulturë, tjetër, muzeun e kom vizitue si nxanës na patën çu n’shkollë...

Anita Susuri: A ju kujtohet çfarë eksponate ka pasë?

Jusuf Osmani: Po, po, po. Eksponate... po, mu ma së shumti m’ka pasë pëlqy muzeu etnografik, shtëpia e Eminxhikut, nuk e di a e dini ku është?

Anita Susuri: Po, po, po.

Jusuf Osmani: Aty kom qenë. Ajo është, kom pasë qenë po pak ma vonë. Kto ku merrsha vesh unë me eksponate arkeologjike që i kishin hulumtu. Veshjet, po, arkeologji. Mandej histori, s’e disha historinë une, ku disha si fmi. Më interesoishin ma së shumti kjo etnografia, po, kto veglat e punës e tjerë e tjerë. Aty kom qenë. Jetë kulturore në Prishtinë, shkojshim po rrallë në teatër, s’kem pasë traditë. Katunari ku din çka osht’ teatri.

Gëzimi ma i madh, s’di n’cilin vit ka qenë, isha, erdhën prej Shqipërisë, ishte ni liberalizim i kohës, erdh ni ansambël i Shqipërisë. Pata arritë në teatër me siguru ni biletë për herë t’parë me i pa të Shqipërisë, po s’po m’kujtohet viti, nxanës isha, nxanës i shkollës t’mesme. Shkum me pa atë, ka qenë mas vitit, jo valla pasna qenë n’punë, ‘68. Ndryshun raportet në vitet e ‘70-ta e kto vishin ansamblet e tjera.

Në... unë kam qenë në shumë vende të botës, jo të botës të Europës se isha drejtor i arkivit por pregatitsha kumtesa. Tash unë anglisht nuk disha, por në Slloveni e përgatitsha shqip une e përkthejsha anglisht. Çdo konferencë ndërkombëtare ka pasë përkthyes. I jepsha anglisht unë dilsha e lexojsha shqip ai dilke e lexojke anglisht, anglisht. Kom marrë pjesë n'do konferenca po me përkthyes. Kom qenë Kuala Lumpur, kom përfaqësu Kosovën në Malejzi. Kom qenë në Cape Town, Cape Town është në Afrikë të Jugut. Në Kanadë Kuebek city. Pastaj, në, kto Emiratet kom qenë në Emiratet Arabe, këtë, jo kta, osht' tashti pjesa tjetër. Në konferenca ndërkombëtare të arkivistëve se na u pranum në Këshillin Ndërkombëtar e m'thirrshin mu.

M'thirrshin edhe atje... po shumë me randsi osht' me qenë në nivel. Në nivel edhe të sjelljes edhe të njohurive. Pse të sjelljes? Se shqiptartë si shqiptarë bie n'sy më shumë. Shqipëria ishte e mbyllur deri vonë. Unë kom qenë niherë në Çeki, atëherë ish Çeko-Slllovak. Nji shkollë verore e fitova... tërë verën atje e kalova. Pata kontakt me të tjetër, folsha rusisht se pata msu prej zorit. Diskutojsha. U ndajshin sipas gjuhëve. Kta të Europës veri-lindore gjuhën rusishte. Polakët e slllovakët e besa edhe hungarezët, kta Moldavi e. U takojshim edhe diskutojshim në përgjithësi.

Unë atëherë isha t'u studiu magjistër. S'isha magjistër po isha t'u studiu. Diskutojsha. Ju ra n'sy. Ni ruse po ma bon, m'tha, "M'fal që po t'thom diçka po", tha, "po du me t'thanë. Kom mendu", tha, "shqiptarë janë magjup⁴", "Pse?" Tha, "Në bazë të shtypit edhe shkrimeve", thashë, "Po qysh po t'dokna unë?" Tha, "Jo", tha, "n'koftë shqiptartë qishtu", thashë, "Jo unë jom mesatar". Domethonë me lonë përshtypje.

Se shkon ni i huj tjetër nuk ju bjen shumë n'sy. Ku kom shkue jom përgatitë dhe në kontakte që kom pasë kom qenë në nivel. Kshtuqë sot kom miq e shokë. Në kohë të fundit, kto libra që i botova {tregon me gisht nga librat mrapa} në 20 vitet e fundit nuk mujsha me shku unë në Bosnje. Slloveni e Kroaci mujsha po ma problem ish. Krejt m'i kanë çu shoktë shënimet. Çka m'u dashke veç ju shkrujsha në arkiv ose bibliotekë, m'i skanojshin edhe m'i çojshin dokumentet edhe librat. Falë njoftësisë edhe kshtu përshtypjeve që kom lanë.

Po tash janë ndrru gjeneratat, kanë ardhë tjerë prap emri jem është si arkivist i regjistrun. Kur isha në Zagreb qitash drejtori gjeneral, se ku m'njofti i Arkivit të Kroacisë, kur e hapi tubimin tha, "Kemi nderin që në mesin tonë është profesor doktor Jusuf Osmani, arkivist, doktori i parë i arkivistikës në ish Jugosllavi", ata apllauz edhe m'kqyrshin. Ni shqiptarë me arritë. Po na si individ jemi shumë të aftë, si individ. Si shoqni jo, si grup jem shumë të dobët s'mujmë me bo njani me tjetrin.

Anita Susuri: E ju në '78-ten keni fillu në Zagreb apo i keni përfundu? Si ka ndodhë?

Jusuf Osmani: Jo, në '72-ten kom diplomu në fakultet. '73-ten kom shku në Beograd në specializim edhe regjistrova në Zagreb. '73 studimet post-universitare. '76 e kom mbrojtë temën e magistraturës

⁴ Term derogativ për komunitetin rom.

në Zagreb, 1976. '77-'78 mendojsha çka me regjistru, në Beograd afër por rrethanat ishin ndryshe. U merrsha me kto, ju tregova për ekspozitë në '78-ten edhe '79-ten e regjistrova doktoraturën.

Ktu gjeografinë e kom pasë, shkollën e lartë histori-gjeografi në Gjakovë, a ktu gjeografinë. Po mandej u specializova për arkivistikë. Se osht'... e çka ka qenë dëshirë e ime e fundit. Po tash dëshirat, po po mendoj çka me dhanë. Me lanë pasardhës që ndonjë arkivist. Isha i angazhuar n'fakultet prej 2005-tes kom dhanë msim si bashkëpunëtor i jashtëm.

Dojsha me hapë degën e arkivistikës, nuk gjejsha mirëkuptim. Se vishin do rektor thojshin, "Po çka po na duhen po kërkojnë kta të historisë honorar me hapë". Po erdh Ibrahim Gashi ni kohë rektor edhe dekan i fakultetit Bujar Dugolli, dytë i kisha shokë. Thashë, "Me më ndihmu". 2015-ten e paraqita kërkesën, e bona programin krejt erdhen ata të me akreditu, të jashtëm kanë qenë.

M'kujtohet erdh për arkivistikë njo i Holandës. M'thirrin mu. Unë ia çova tetë libra të arkivistikës. Thanë, "Pse po don me hapë?" Thashë, "A p'e sheh që unë jom mush edhe du me lypë kuadra". Hinëm në bisedë tha, "Çka ke kry?" Po i thom, "Doktoraturën", "Te kush?" "Te Zhantari" veç kur po m'kqyrë. Tha, "Po shoku jem është Zhantari, bashkëpunëtori jem", thashë, "Ai është mentori jem".

A besoni i ka palu letrat. Ia kena nisë bisedë private me përkthyes. Ish ni vajzë e Jahja Drançollit është profesoreshë. Si u dalë i kish thanë, "Babë, u akreditue", "Po s'e kanë", "Jo, jo", tha, "u akreditue. Axha Isuf", tha, "e akreditoj", "Po qysh?" Tha, "Ai profesori i ka mbyllë dokumentet aty s'shënonte ma hiç", tha, "u aprovu". Se më krynte ni profesor me renome, në Slloveni e ni universitet edhe e lash.

Punova deri në moshën 70 vjeçare dhash mësim aty. I qita dy gjenerata. Mandej s'kisha t'drejtë me punu ma se në moshën 70 vjeçare. Vazhdun po ni vjeçare, s'ia akreditun dy vjeçare. Ni far' lloj kursi, po vazhdon arkivistika. M'kanë dalë do kuadra shumë t'mira t'arkivistikës. Kom punu me përkushtim. Po kjo ka qenë dëshira ime që t'lo dikond mbrapa edhe ia kom arritë.

Anita Susuri: Po më inereson, ju thatë që keni punu në Arkiv të Kosovës...

Jusuf Osmani: '73-ten, po.

Anita Susuri: Qysh keni fillu edhe çka ka qenë fillimisht rrugëtimi juj aty? Qysh ka shku krejt puna po më intereson?

Jusuf Osmani: Po. Une prej shkollës ktu shkova punova në Entin për Punësim ku ka qenë ni shkollë e mesme sot është Shtjefan Gjeçovi. E kisha axhën drejtor. Tha, "Hajde". Diplomova në '72-ten edhe n'fund tha, "Hajde profesor aty". Pagat dyfish ma t'mdha. "Banesën", m'tha, "për pesë vjet e ke t'sigurt, hajde". Shkova punova gjashtë muj. U hap ni konkurs në arkiv për inspektor i arkivit. Shkova, thashë, "P'e lshoj se po më marrin atje". Më morën inspektor se ju vyjke raportet m'i shkru me makinë. Unë

disha se kisha kry shkollë t'mesme. Tha, "Qysh p'e lshon? P'e hupë banesën, pagën dyfish", thashë, "Valla e kom regjistru shkallën e tretë", e pata regjistru, thashë, "du m'u marrë me veprimtari hulumtuese, kërkimore, shkencore", "Ani, ani". Edhe shkova punova në arkiv deri në kohë të... deri '87-ten punova në Arkiv të Kosovës. Mandej kalova në Arkiv të Prishtinës deri '89-ten.

Atëherë me heqjen e si për drejtorit dhe u ktheva në Arkiv të Kosovës në vitin 2000 si kryeshef. Deri në 2010 kom qenë udhëheqës i Arkivit të Kosovës, 2011. I kisha edhe dy vjet se 2012-ten dilsha në pension. Erdh tjetër kush. Kom vazhdue. Kshtuqë e kom shfrytëzu se falë arkivit unë jom ky që jom. Pse? Kom pasë dokumente n'dorë, kom pasë informatën. Mos e paqa pasë në arkiv kom shku si arkivist në, në, kta, nëpër arkiva tjerë i kom pasë dyert e hapura. Osht' interesant pse ia kom nisë me botu për dy projekte me rëndësi madhor. Kjo po e shifni "Vendbanimet e Kosovës" një deri në 20. Në vitin 1987 m'ra n'durë ni libër, kaq madhësi {tregon gjerësinë e librit me duar} "*Zadužbine Kosova*". E kish botu, domethonë, "Përshpirtësia e Kosovës", e kish botue Boboslovia në Prizren edhe kisha, qysh p'i thojnë, në Beograd.

Po i lexoj vendbanimin. Çdo vendbanim krejt i paraqet sllav. Kanë kriju mesjetar sllav, sllav, sllav. Unë kisha njohuri si gjeograf se ato janë shumë ma t'vjetra edhe i kom hy '87-ten hulumtimeve. Dokumenta, literaturë edhe kom shku çdo katund edhe kom bo monografi për komunën. 20 libra janë. Kom dëshmu autoktoninë e shqiptarëve në Kosovë. Me demantu, me i demantu thanjet e tyre dhe arrita në 2006 ta përfundoj librin e fundit, "Sharr" në bazë të dokumenteve.

Si drejtor më erdh një shkresë prej Arkivit të Kroacisë, Arkivit të Kroacisë në 2000-ten, 2001 në të vërtetë. Me i tubu t'dhanat, me i grumbullu t'dhanat për lufrat. Ata thojshin konfliktin e fundit në ish Jugosllavi. Unë ia ktheva përgjegjën thashë, "Po". E bona projektin, fillum punës për me i hulumtu krimet e luftës në Kosovë që janë bo. Formova ni grup prej çdo komune. Dështoj ai projekt. Serbët nuk pranun, boshnjakët ajo ana serbe nuk pranun, maqedonët kshtu. Unë vazhdova.

2010 e përfundova projektin dhe kur ishte, ju t'ri jeni, ajo Ahtisaari, jo Ahtisaari, ai Dick Marty, unë dola dhe e botova librat. Kqyr ku janë ato atje {tregon librat mrapa} "Krimet serbe" ato dyja. Anglisht. Ajo tjetra, "Krimet serbe ndaj fmive" edhe i përktheva anglisht edhe paraqita fakte për krime që janë bërë në Kosovë. 1373 fëmijë që janë vra në Kosovë krejt me emra me mbiemra dhe përfundova atë projekt. Domethonë dy projekte madhore. Ajo e vendbanimeve mandej kjo krimet. Mandej ky tjetri për kto, për shqiptarë në Sanxhakun e Nishit. Po kom vepra shumë tjera që kom hulumtu. Që ato janë një, dy, tre {tregon librat mrapa} për konolizim, reforma agrare doktoraturën që kom pasë.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Deshta me ditë për punën e juje në arkivë, po më intereson pak ma shumë për dokumentet që i ka pasë arkivi n'kohën kur keni fillu edhe...

Jusuf Osmani: Po.

Anita Susuri: Gjatë kohës domethonë, çfarë periudha?

Jusuf Osmani: Po arkivi osht' themelu në vitin 1951. Po dokumente kta të periudhave shumë t'ma hershme. Se memoria e kombit është arkivi. Aty ruhen dokumentet me vlerë historike, shkencore, juridike. Pa dokumente nuk ka histori. Dëshira ime t'shkoj t'punoj aty. N'kohën kur isha inspektor pata marrë shumë dokumente nga institucionet, nga institucionet. Sidomos dokumente në gjykatë. Dokumentat e gjykatave të qarkut. Sepse kishim vend edhe ia disha randësinë e tyre. Mandej bonëm hulumtime në arkiva të ndryshme, të rajonit.

Sidomos të, në, në Vienë, në Londër, në Paris me bashkëpunëtorët që i njifshin gjuhët. E unë ia kushtova vjeljes së dokumenteve nga institucionet sjellja në arkiv. M'kujtohet rastet i pata gjetë dokumentet e kolonistave, ata që kisha me punu, punojsha n'temë të doktoraturës. Ni serb po më tregon, ni Millovan Obradoviq, ka punue edhe ai për Reformën Agrare. Po i thom, "Ku i gjete?" Edhe po më tregon tha, "Janë në Këshill Ekzekutiv në drejtorinë e kadastres". Shkoj unë si inspektor po i kërkoj. Tha, "Nuk bon", se ishin serb ata...

Anita Susuri: Në Kosovë?

Jusuf Osmani: Në Kosovë. Tha, "Nuk bon m'i marrë se janë për mbrojtje popullore kto", nuk dojshin m'i dhanë. Me Haki Bajramin ish drejtor, kemi shku te Sali Nushi për arsim e kulturë, i sekretariatit. Ish edhe Imer Jaka. Po i thojmë qishtu qishtu. "Neve na takojnë, janë periudha para luftes". Ai dha urdhërin dhe i morëm. Qato dokumente '98-ten, jo vitet e '90-ta kur hyn masat e dhunshme në arkiv i kanë marrë i kanë çu në Beograd. Kanë marrë edhe diçka tjetër po fati që nuk arritën. Domethonë detyra jeme ka qenë që t'pasuroj arkivin si inspektor. Pasi si drejtor qëllimi ka qenë që ma së shumti dokumente kem në Turqi, në arkivat e Turqisë. Aty ka me miliona dokumente për ne...

Anita Susuri: Çfarë dokumente janë ato?

Jusuf Osmani: T'periudhës prej shekullit 15-të, 15-të, dëfteret osman e deri në vitete '60-ta. Pse vitet 1960? Se shqiptartë deri atëherë që janë shpërngulë në Turqi. Ka me miliona. Si veprova? U takova me drejtorin e arkivave të... jo ma së pari e mora ni turke me punu në arkiv. Në Vienë në 2004-ten u takova me drejtorin e Arkivave të Turqisë, ni Jusuf Sarinaj.

Isha me drejtorin e Arkivit të Shqipërisë, doktor Shaban Sinanin. U njoftum me to edhe ai po m'thotë, "Qysh na s'jemi taku? Pse s'po bashkëpunojmë?" Thashë, "A je ti i interesun?" Tha, "Jom i interesun". Se ata dojshin m'u afriu me Kosovë se tradita, adete, zakone edhe kanë qenë ni kohë t'gjatë ktu që kanë

sundu. Si kthehna une ia boj ni kërkesë, e ftoj. Ia çoj ambasadës ktu, ambasada ia përcjellë Ministrisë së Punëve të Jashtme, ata atij.

Ai vjen me ni grup, me ni grup, na viziton. E nënshkrujmë protokollin e bashkëpunimit, 2005-ten në shkurt. Fillojmë me hulumtu dokumente. Me sjellë. Ajo turkja edhe ni profesor Ilaz Rexha që e njëfsha i dërgojshin edhe na sjellshin dokumente. Por është problem se duhet kuadra me i dëshifru ato. Osh t' ni arkivë tjetër, arkivi i kadastrës dhe i tapive. Krejt tapitë e pronave të Kosovës, Sanxhakut të Nishit, krejt Ballkanit që kanë pasë kta Turiqa nën sundim ishin te ta.

Po m' thotë ajo kolegia, tha, "Kanë shprehë dëshirën me ardhë mysafir ata te ne se ju kanë tregu kolegët e arkivit tjetër që kemi qenë, jemi nda t'knaqur", i pritëm, në Prizren u knaqëm kur i çum se oriental. E aq u ndan t'knaqun. Bile për herë t'parë kom qenë edhe unë ni namasgja ish aty. Ata u falshin e. Po i tregojnë që kemi qenë. Ata tash po i thojnë asaj, "Hajde edhe na shkojna". Po m' thotë, "Po m' thojnë me i thirrë". Thashë, "Shkruja kur doni edhe sa doni eja".

Erdhën tetë të arkivit të kadastrit, erdhën tetë. I pritëm mirë. Tha, "Qyre, ne i kem tapitë e tokave t'juve, kujt nuk ia kena dhanë. Drejtoni procedura qysh shkon ambasadës, ambasada Ministrisë së Punëve të Jashtme, ministria na drejtohet neve. Se na japim mendimin", tha, "na japim pozitiv". Unë veproj ashtu. I kemi marrë ni milion e sa tapi pa kurfar' pagese. Prej Sanxhakut të Nishit, t'u u përfshi ni pjesë e Shqipnisë, të Maqedonisë ni pjesë edhe të Malit të Zi, janë sot. Po thom ni milion e 300 mijë tapi që janë në mënyrë digjitale. Pa asni cent na i dhanë veç falë bashkëpunimit.

Unë edhe vjet isha hulumtova për xhamitë edhe s'më kanë pagu asgjë. Krejt m'i kanë dhanë pa kurfar' problemi. Domethonë qëllimi ka qenë me pasuru arkivin. Pse? Ato dokumente të defterit osman, tash dalin i boton Ilaz Rexha. Ilaz Rexha është në Holandë është gjyshi i Dua Lipës, prej nanës. Ai e njëf osmanishten. E boton defterin e Sanxhakut të Prizrenit 1530-ten shekulli 16 edhe e boton defterin e kadalullkut të Janjevës 1490, defterin po kësaj kohe të Novoberdes. I kem dorëzu në Shkup. Unë i kom ndihmue me i sistemue edhe me identifiku vendbanimet.

Çka osht' qëllimi? Me tregtu autoktoninë. Se serbët kanë shkru, kanë botu deftere po krejt na paraqesin t'ardhun ktu. Në Kosovë thojnë s'ka pasë shqiptarë, ktu ka pasë serb. Tash dokumentet, kto shkrimet e mija bazohen në bazë të dokumenteve dhe dëshmija se na jem, na jemi kshtu, vendas ktu. Serbët janë ardhë në fund të shekullit të 12-të.

Anita Susuri: Ju m'tregutë që keni pasë edhe kshtu për shembull në vendet në Europë...

Jusuf Osmani: Po.

Anita Susuri: Kshtu vizita. Jeni shku po qëllimi ka qenë me hulumtu nëse ka ndonjë dokument apo?

Jusuf Osmani: Po. Kshtu, kanë qenë të ndërlidhura. Kur kom qenë në Çeki i kryva obligimet unë drejt shkova në arkiv. Në arkiv po shfletoj. E gjej ni fond, s'e di a keni ndëgju ju, është vra Cernabig Kryeziu në... Ahmet Zogu e ka vra në 1927-ten. Ndërsa ai vrasësi Alqibiad Bebi dënohet e Gani Kryeziu i Gjakovës e pagun ni roktar t'vetin Xah Kosovën, janë edhe kangtë. Shkon e vran në sallë të gjykimit atë. Unë shkoj i gjoj ato dokumenta edhe botoj libër, libër e botoj. Në vitin 2000 nuk isha në arkiv të Kosovës, SOROSI, shoqëria e hapur e kisha ni shok, ni sllovak me dhanë ligjerata në San Petersburg në gjuhën ruse. Arkivistëve të disa shteteve. M'thirrë mu me dhanë ligjeratë, me mbajtë ligjeratë. Bile ka qenë tema, vlerësimi i dokumenteve arkivore, sa duhet m'u rujtë. Disa shtete vishin. Shkova atje i mbajta do orë vazhdun kishe edhe shtetet tjera. Vazhdun unë thashë, "Po shkoj në arkiv me hulumtu".

Shkova nuk më lanë m'u ofru te dera e arkivit. "Kush je? Çka je". Kthehna. Ajo administratorja po m'pytë, "Pse u ktheve?" Thashë, "Nuk më pranun", tha, "Si?" U shku e ka shkru ni depeshe i thojnë me atëherë kanë qenë kto me telegraf. Jo me telegraf po me faks e ia ka çu atyne. Tha, "Qe ni kopje". Jom shkue t'nesrit te dera m'kanë pritë. Tha, "Profesor", se e morën vesh që jom arkivist, "urdhnoni", m'pritën aq mirë. Çka me hulumtu tash duhet me ditë. 1903 Rusia e ka hapë konsulatën ruse në Mitrovicë edhe ka... Isa Boletini edhe shqiptarë tjerë kanë kundërshtu.

Ai konsuli Sherbini vjen aty vendoset. Shqiptartë nuk mujnë me duru edhe e vrainë. Vrasja e konsulit rus në Mitrovicë. Unë i gjeta dokumentat edhe e bona libër edhe landën po ashtu. Kom shkue te djemtë e merrsha njëni prej djemve ose djalit t'vllaut edhe në arkiv tanë kohën t'u hulumtu, t'u sjellë dokumente. Ashtu kom vepru në Beograd, në Podgoricë, në Shqipëri kohën e fundit. Ku kom shku ka qenë, jo qëllimi vizitë kshtu, por me shfrytëzu se kom qenë i pasionuar në dokumente.

Anita Susuri: po deshta edhe me ju pytë nëse keni pasë t'drejtë me i marrë kto dokumente ose kopje që me qenë edhe në arkivë të Kosovës për tjerë me hulumu. Për shembull, a keni pasë t'drejtë kshtu?

Jusuf Osmani: Po, po. Ma së pari në Beograd kur kom fillu doktoraturën. Atëherë dokumentet janë mikro filmu. Jo s'ka pasë digjitalizim. Janë konë fotokopjim, po aty shumë, po filma. I kom marrë krejt ato janë në Arkiv të Kosovës. Ku ka pasë pak, kom hy edhe në arkivin ushtarak, institutit ushtarak po do nuk m'i jepshin se isha arkivist unë, e disha çka ka.

Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme në Beograd dokumentat kryesore. Kanë qenë vitet e '80-ta unë isha me detyrë me hulumtu kolonizimin e kisha. Kom marrë... kto arkiva tjera i fotokopjojsa, i fotokopjojsa fotokopje ose i mikro filmojsha. Ata i mikrodilmojshin shërbime unë i pagujsha. Bile ni hartë e kom pagu në Londër 70 funta, 70. Osht' e 1873-tes, atë hartë e shfrytëzoj. Krejt janë vendbanimet e ksaj pjesës së Ballkanit.

Mandej kto deri mas luftës filloj digjitalizimi po ka qenë shumë ma lehtë. Domethonë çka kom hulumtu i kom sjellë në arkiv. Edhe dokumentet e mija personale edhe t'krimeve t'luftës edhe

t'damëve t'luftës edhe fondin se kem pasë punu ni grup për standardizimin e emrave të Kosovës. Të gjitha i kom dorëzu në Arkiv të Kosovës.

E pat' vitrinën zbrast aty, ato raftet. Kom dorëzu edhe libra profesionale, libra kom pasë shumë të arkivistikës që kom marrë nëpër konferenca e tubime që m'i kanë dërgu në arkiv. Kom pasë revists, Jetën e Re, Përparimin dhe revista tjera i kom dorëzu në bibliotekë të Kosovës. Tash kto t'mijat ia kom nda djemve. Në Prishtinë, ktina p'e shihni {tregon librat mrapa} edhe e kanë obligim moral se rejat kur po vijnë, lshoma hiq librave, me i rujtë, me i shfrytëzu.

Pasqyra e ni shtëpisë është biblioteka, libri. Se thojnë ni shtëpi ku nuk shef libra, mos fol se nuk t'kuptojnë. Prandaj, ku kom shku s'ka qenë qëllimi vizitës vetëm me marrë pjesë në mënyrë pasive. Por ose kom marrë pjesë me ndonjë diskutim ose kom lidhë marrëveshje bashkëpunimi me ta. Në Vienë kom pasë marrë se di sa mikro filma, atëherë s'kom qenë drejtor, i patëm ble. Në kto, në Paris kom qenë ni shkollë 15 ditë me Ministrinë e Kulturës po aty ma tepër ka qenë vizitë nëpër kto arkiva. Kto shtetet tjera në konferenca, në tubime edhe merrsha revista të tyre m'i dërgojshin, i këmbeshim kshtu.

Anita Susuri: E po më intereson edhe si është përcaktu në fakt edhe a ka qenë e përcaktune cilat dokumente janë për publikun e cilat janë të ndalune? A ka pasë edhe në Kosovë kshtu diçka?

Jusuf Osmani: Dokumentet ma t'randësishme në Kosovë që kanë qenë dosjet që po i qujnë dosjet e personaliteteve, kanë qenë në Sekretariatit Krahinor të Punëve të Brendshme. Atë e kanë pasë ni arkiv shumë t'pasur. Unë si inspektor kam hy po nuk kom guxoftë me hulumtu se aty punojshin serbët. Nëpërmjet lidhjeve hyna aty. I kom pa me mija dokumente, dosje. Mas luftës meniherë kur jom kthy jom shku ajte. Asnjo s'e kom gjetë. Kom pyetë, "Ku janë?" Thanë, "Janë djegë".

Unë kur shkova atje nuk ishin djegë se shifen letrat e djegta po i kanë marrë në Beograd. Dosjet në arkiv. Se shumë duhet me pasë kujdes që mos të preket identiteti personit. Shkon ti hulumton, gjen ni dokument kundër dikujt atë nuk guxon pa kalu bile 50 vite, 50 vite duhet me kalu për me botu ni dokument t'tillë. Dokumentet e gjykatave ka pasë, ka pasë ndonjë shkresë, ndonjë raport, ndonjë raport që ka folë kundër tjetrit. Si dëshmitar ka folë, ky ka bo ktë, ka bo ktë.

Atë unë e kom pasë ndalu nuk ia jepsha. Ia jep vetëm t'familjes, jo tjetër kush. Për studime është formë tjetër, ato janë në arkiv. Kto tjerat dosjet i ka marrë Beogradi nuk ka. Qito që thashë për konolizim, për do t'kishave... sekretariati i punëve të brendshme por edhe kumeditë çka kanë marrë. Sikurqë janë në Shqipëri dosjet që po bohet deklasifikimi i tyre ktu ende nuk ka. Po janë t'u kriju se janë institucionet që i mbajnë arkivat sekrete. Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme, AKI-ja ka. Ato janë dokumente që s'kanë qasje gjithkush n'to.

Anita Susuri: E për shembull për m'u arkivu ni dokument, çfarë procedure ka qenë? Sa staf ka qenë i involvuar?

Jusuf Osmani: Po qy, arkivat, Arkivi i Kosovës kryesisht e ka dokumentacion t'marrun prej institucioneve, qeverisë, gjykatave, shkollave e tjerë. Por nuk kem traditë dokumentacionin e gjujta. Shkoni edhe sot kush nuk kujdeset. Nëpër koridore, nëpër tavane ka që i rujnë e kujdesen. Ka fillue tash ni qasje ma, ni kujdes ma i madh ndaj dokumenteve, ato dokumente janë marrë.

Çdo institucion është i obliguar pas 30 viteve me dorëzue arkivin e vet, dokumentacionin e vet në arkivin shtetëror, në arkivin kompetent. Pse? Për shembull te Rajoni i Prizrenit është Arkivi i Prizrenit, i Pejës atje dorëzohet, ktu janë institucionet qendrore në Arkiv të Kosovës. Po ekzistojnë edhe arkiva speciale që thashë i sekretariatit. Ata niherë nuk e dorëzojnë.

Pra, qëllimi osht' për me punu në arkiv duhet me qenë i parapregatitur. Me ditë vlerën e dokumentit, me ditë metodologjinë e rregullimit, përpunimit dhe prezentimit të publikimit. Osht' ni, arrihet me, nuk arrihet vetëm e kreu fakultetin, duhet kurse. Çdo herë duhet arkivisti me qenë n'rrjedha të kohës. Se dokumentet po krijohen n'forma t'ndryshme. Tash në forma digjitale. Po vijjnë në forma elektronike. Arkivisti duhet me ditë ma s'pari gjuhën e dokumentit.

Fatkeqësisht te na që janë ardhë t'ritë nuk p'e dijnë serbishten. A dokumentet deri n'vitin '74 pjesa dërmuese janë ksi në gjuhën serbe. Tash duhet me ditë anglishten për me komuniku. Domethonë me përcjellë rrjedhen e dokumentit, zhvillimin edhe me punu sipas standardeve ndërkombëtare. Pse? Na jem në Kshillin e Arkivistëve sepse komunikimi duhet me qenë unik. Nëse punon me metoda tjera të komunikimit nuk mund të komunikojsh me shtetin tjetër. Se është ni standard te dokumentet.

Ato Këshilli Ndërkombëtar i Arkivave ka pru standarde. Unë i kom përkthi ato në gjuhën shqipe edhe në Shqipëri po i përdorin. Por ato standarde janë të përgjithësune duhet m'i fut ato specifikat e shtetit. Na s'mundëm sikur Franca ose Anglia se ato e kanë ni nivel shumë ma t'rregullun, na e kem t'hedhun, t'gjujtun, domethonë duhet me ditë. Çdo gjë që krijohet nuk ka vlerë.

Dokumentet janë ato që kanë vlerë historike, shkencore, juridike. Çka osht' juridike? Me i realizu t'drejtat. Tokës, t'shkollimit, t'drejtat personale. E tjerat kanë afat pesë, dhjetë, 30 vjet asgjesohen. 20% ruhet e përhershme. Se faturat, ni organizatë komerciale me mijëra fatura ka. S'ka nevojë m'u rujtë, ruhet ni raport vjetor. Duhet me ditë profesionin. Nuk munësh as me qenë menaxher i mirë kur s'e din atë lami.

Anita Susuri: A keni bo ndonjë lloj kategorizimi ose diçka të dokumenteve?

Jusuf Osmani: Në arkiv, po, në arkiv kur kom ardhë fillimisht kam, i kom bo udhërrëfyesit. Hulumtuesi kur vjen duhet me pasë regjistrin e fondeve.

Anita Susuri: Ju i keni bo ato për herë t'parë?

Jusuf Osmani: Sa kom qenë unë për herë t'parë edhe janë t'fundit fatkeqësisht. Tri vëllime i kom bo, i kom bo sipas lamive. Për shembull, organet shtetërore, arsimit me kulturë, kjo ekonomia, ekonomia që hin industria e tjerë. Tjetër ka qenë mbrojtja popullore, nën lami është ajo. I kom bo i kom botu. Për secilin fond, se na fond e qujmë, çka ka aty.

A në shtete tjera e kanë digjitalizuar veç hin n'kompjuter edhe e lypë në bazë të emrit, vendit edhe në bazë të fjalë kyçe. Për shembull po më intereson për shpërnguljet veç e shkruaj shpërngulja, refugjat ta qet' aty. Unë isha hulumtova edhe më interesojshtin muhaxherët në Turqi. Veç ma qitke muhaxherët. Më interesojshtin xhamitë atje, ma qitke xhamitë. Më interesojshte çka ka për Prishtinën, m'i qitke. Po u dufke me ditë se a i kanë shkruar Prishtina, Piristina disa forma. Ni gërmë e ndryshon nuk ta qet. Kto janë.

Duhet me ditë çka po punon. Jo vetëm... fakulteti është letër. Fatkeqësisht sot po doktorojnë. Qysh po doktorojnë... po shkon profesor në fakultet, qysh po doktorojnë unë s'po hy anej, keni ndëgjju. Po shkon me ni universitet në privat në Shqipëri, në Greqi, në Maqedoni edhe po bohet doktor shkence. Me forcë po shkon profesor në fakultet. Profesor osht' ni libër s'e ka t'shkrune. Domethonë atë librin për student. Unë si kom shku e kom bo librin e arkivistikës dhe disa tjera për student. Qe ktu i kom t'gjitha.

Anita Susuri: A ka pasë që kanë ardhë në arkiv kanë hulumtu? A ka pasë domethonë, a kanë pasë qasje?

Jusuf Osmani: Po, po edhe atëherë edhe sot. Osht' salla e leximit, punohet. Me përkushtim punojnë kolegët e arkivit, ju shërbejnë. Por duhet punë me... ma s'pari me u sistemu pastaj m'u digjitalizuar ato dokumente. Por duhet përgatitje paraprake. E kreu fakultetin, shkova n'arkiv. Nuk osht' se s'din çka osht' fondi, s'din çka osht' dokumenti, s'e din vlerën e dokumentit, cilat si rregullohen. Krejt janë t'përcaktuar me norma ndërkombëtare.

Anita Susuri: Po du edhe diçka me ju pyetë, osht' edhe prej përvojës teme pak a shumë, gjatë ni hulumtimi që e kena bo si organizatë në Arkiv të Kosovës kom qenë edhe e kom pasë dokumente që janë për shembull të vitit 1920, 1924. A mendoni që duhet pak ma shumë me pasë mbikqyrje si punohet me kto dokumente? Për shembull ato janë n'dorë t'dikujt që ka kujdes po ndoshta dikush nuk ka kujdes ose mundet me i përvetësu ose...

Jusuf Osmani: Me vjedhë bre (qeshë).

Anita Susuri: Me vjedhë (qeshë). Ose me dëmtu.

Jusuf Osmani: Kqyre, me dëmtu...

Anita Susuri: A ka qenë ma ndryshe ma herët? Si ka qenë kjo e mbikqyrur?

Jusuf Osmani: Po njëjtë, na nuk ju kemi kushtu aq shumë. Osht' salla e leximi, a t'rrin ni punëtor aty afër?

Anita Susuri: Kaniherë po kaniherë jo.

Jusuf Osmani: Jo. Duhet... janë do forma t'mbrojtjes. Ma së pari n'arkiv nuk guxon me hy me çantë. Në sallë t'leximit kurrësi. Ki me hi me ni laps t'thjeshtë edhe me ni copë letër nëse don me marrë shënime. Tash janë kamerat. Në Londër edhe çdo arkiv nuk guxon me qit' krahët në dokument, m'i pshtet. Ki' m'i shfletu me kujdes. Pse? Se ai t'përcjellë. Nëse pak s'ki kujdes veç e ke qit' krahun n'dokument a din si te na, meniherë ta tërhjekë vrejtjen. E vazhdove ta merr t'drejtën, s'ki t'drejtë me hulumtu.

Te vjedhja te kto s'guxon se osht' vepër penale. Çdo dëmtim, çdo tjetërsim i dokumentit osht' vepër penale, dënohet edhe n'burg shkon. Askush s'guxon ni dokument me shkatërru e me vjedhë kurrësi. Unë p'e vjedhi ni dokument, du me publiku, nesër kur del ku e more, ku e more ti atë dokument.

Te na po doktorojnë dokumente që s'ka qenë kurrë n'arkiv e thirret në arkivin e landës, Arkivin e Vienës, Arkivin e Stambollit a kurrë s'ka qenë. Pse? I ka marrë prej tjetrit që ka qenë edhe e qet aty kinse ka qenë. Ai është falsifikim. Është keqpërdorim, jo falsifikim, keqpërdorim. Kur shkoj unë, boj kërkesën, m'hapet dosja aty çka kom hulumtu. Kërkesa jem edhe çka kom marrë, dihet, dihet.

Nuk guxon me, bile tregti hiç. Unë e kom gjetë ni dokument n'arkiv, duhet m'u thirrë n'arkiv përndryshe nëse e shkruj që osht' i jemi, ku e more, e kom vjedhë pra. Duhet me pasë kujdes. Arkivi duhet shumë... edhe ai hulumtuesi duhet me qenë i vetëdijshëm. Por ka s'osht' ai por edhe arkivi duhet me përcjellë çdo lëvizje. Në arkiv t'botës ushtria e run, policia. S'guxon.

Kur dilsha unë prej Arkivit të Londrës çantën e lejsha poshtë aty te porteri, e mbyllsha, m'i kqyrke çka kom. Nëse kom ndonjë dokument të fotokopjun e kqyrke faturën që e kom pagu, ku e mora. Të përcjellë, të kontrollon. E mos t'thom kamerat, tash me kamera çdo lëvizje ta përcjellë, çdo lëvizje. Te na hala nuk jemi n'atë nivel. Po shpresoj se me kalimin e kohës edhe kto tejkalohen.

Anita Susuri: Deshta me t'pytë edhe për Arkivin e Prishtinës, qysh ka qenë puna aty?

Jusuf Osmani: Po, Arkivi i Prishtinës një ndër shkollat e para osht'. Unë ni koleg i ndjeri Hysni Halili ka vdekë, kërkum pse ishte pronë e Ministrisë së Arsimit. Kërkum prej ministrit, ministër ishte ni i afërt i

imi Rexhep Osmani edhe na dha atë ndërtesë. Fondi European e renovo, e pajisi dhe osht' një ndër arkivat ma modern në rajon. Me, se di a e keni pa, i ka ato raftet të mbyllne, e ka sigurinë në nivel, e ka zjarrin, aparatën kundër zjarrit, ma të avancumet. Një ndër arkivat që nga aspekti i mbrojtjes dhe sigurisë është ma të avansuara në rajon.

Anita Susuri: E kjo u bo mas luftës?

Jusuf Osmani: Kjo mas luftës.

Anita Susuri: E n'kohën kur keni shku atëherë '87-ten?

Jusuf Osmani: '87-ten ka qenë ni ndërtesë e vjetër edhe sot osht' atje ku osht' ndër Këshill Ekzekutiv ka qenë ni post, ju s'e mbani mend, aty është bombardu. Është ndërtesë e vjetër ka qenë. Niherë gjykatë, burg, kish pasë edhe kanalet ku i kanë çu i kanë vra nëpër tokë, kanalet. Burg mandej bankë e aty arkivi ka qenë. Mandej, arkivi u mur' ajo ndërtesë e sollën në Arkiv të Prishtinës, ktu në Arkiv të Kosovës. Nuk ka qenë kushte t'mira.

Nuk i kanë kushtu... po tash arkivat në Kosovë janë të centralizune. Ekziston agjensiona shtetërore Arkivat e Kosovës 2009-ten e patëm bo dhe arkivat rajonale i qujnë ndërkomunale që janë në vartësi të agjensisë, agjensisë. Domethonë deri në Shqipëri është me emrin drejtoria e përgjithshme e arkivave të Shqipërisë, te na agjensioni. Është e centralizun, ashtu edhe n'botë.

Pjesa e Pestë

Anita Susuri: A keni pasë bashkëpunim edhe me muzeun për shembull? Muzeu i Revolucionit ka pasë shpesh kto ekzpozita?

Jusuf Osmani: Ka ekzistu Muzeu i Kosovës dhe Muzeu i Revolucionit. Muzeu i Revolucionit pat' dalë ktu ku osht' biblioteka tash galeria, ku osht' galeria. Unë kom qenë shumë bashkëpunues edhe me Muzeun e Kosovës edhe me bibliotekën, organizojshim ekspozita të përbashkëta. Për shembull, Muzeu i Revolucionit atëherë ka qenë tjetër, Shefki Stublla ka qenë drejtor. Bashkëpunonim po ma shumë me Muzeun e Kosovës na lidhshin. Se organizojshim ekspozita.

Ekspozita nuk organizohen jashtë qytetit po duhet aty lexuesit, ky vizitori t'ketë qasje ma afër. Kem pasë ekspozita të përbashkëta, ato ndonjë ngjarje historike. Ato i paraqitshin eksponatet, ato artifaktet e kohës, fotografitë na dokumentet. Kshtuqë kem pasë bashkëpunim...

Anita Susuri: Çka për shembull? Çfarë periudhe ose çka...

Jusuf Osmani: Po për shembull e kem pasë ni ekspozitë për Prishtinën. Prishtina gjatë historisë. Prej periudhës antike deri në ditët e sotme. Për Lidhjen e Prizrenit bashkë me muzeun e kemi pasë ba. Pastaj, për ndonjë personalitet m'kujtohet me Shqipërinë e patëm bo ekspozitën e De Radës. Mandej deri Bataljanit e Atlantikut e patëm ba. Ekspozitën e Skenderbeut kur ishte përvjetori i Skenderbeut. Pastaj, ni ekspozitë shumë voluminoze, gjenocidi serb në Kosovë. Ishte Nysret Pllana, sot e patëm botu atë libër, kem pasë problem.

Domethonë arkivi ka edhe veprimtarinë kulturo-propagandistike, se nëse nuk del ti para opinionit me tregu çka ke dokumente edhe me pa opinionin dokumentet sidomos shkollat me ardhë m'i vizitu, atëherë je i mbyllur veç për punëtorë shkencor. Mandej organizojshim ekspozita por edhe botojshim revistën Vjetari. Që dojshin, sidomos profesorët e fakultetit, sillnin punime se ka qenë ni rubrikë për tema profesionale dhe ni rubrikë tema historike n'bazë dokumenteve arkivore.

Domethonë me t'gjitha kem pasë bashkëpunim. Varet edhe interesimi. Unë i tillë kam qenë, bashkëpunues me t'gjithë. Por kom bashkëpunu edhe me arkiva tjera. Të Shqipërisë, të Kroacisë kanë hapë ekspozitë ktu, të Turqisë kanë hapë ekspozitë në 2009-tën për dokumentet arkivore në Arkivat e Turqisë për vilajetin e Kosovës. Pastaj Bullgaria, me Bullgarinë patëm hapë ekspozitën Ballkani në harta. Mandej me cilin shtet... me kto kryesisht, me kto. Me Maqedoninë botime të përbashkëta. E kisha ni shok zëvendës drejtor edhe ia botojshim librat. I botojshim, hapshim ekspozitë atje, ata ktu. E kshu.

Anita Susuri: Po po m'intereson ato vitet e '70-ta-'80-ta kur keni punu, a ka pasë ndonjë, a keni pasë ndonjë vizitë në Shqipëri?

Jusuf Osmani: Jo, jo. Unë '78-tën ka qenë drejtori i arkivit, unë s'kom qenë drejtor. Ai u mbajt simpoziumi për Lidhjen e Prizrenit. U mbajt ktu, u hap ekspozita, u mbajt konferencë shkencore. Bile përfundimtare është mbajtë në Prizren, në shtëpinë e, jo kulturës po atë sallën e sporteve Bazhdarhane, aty kem mbajtë. E mandej unë në Shqipëri kom qenë për herë t'parë '95-tën, '95-tën. Aty pata kalue, pata shku kshu në hulumtime se m'vyjshin disa shënime edhe mandej kem bashkëpunu ma vonë po.

'95-tën kom pasë shku, gati ilegale, kah Mali i Zi. Pata marrë do dokumente, qysh m'i pru? Qysh m'i pru dokumentet. T'i merrshin n'kufi, t'kontrollojshin. Por u gjinda. Ish vera, e mora ni çadër si ato t'dillit, t'diellit që janë. I pshtjella dokumentat mrena edhe çadren e mbylla e lidha poshtë edhe e lash n'autobus atje. Neve na qitën krejt jashtë udhëtarët. Hypën ata, po kontrollojnë e panë çadër. S'ju ka shku menja që ka dokumente edhe m'i pasë gjetë s'isha lajmëru. Por, ashtu i kom sjellë, ashtu i kom sjellë.

Anita Susuri: Çfarë dokumente kanë qenë ato?

Jusuf Osmani: Kanë qenë bash për Cana Begun. Pata marrë në, atje në Pragë por për me qenë ma t'plota u dufke edhe me marrë edhe dokumentet e parlamentit shqiptar. Si e kanë trajtu Shqiptartë çështjen e vrasjes t'tij edhe gazetatat e kohës që kanë dalë dhe kanë shkru për atë ngjarje, për atë.

Anita Susuri: Si ka qenë puna n'grup për shembull e juve arkivistave, po mendoj stafit t'juj? Çfarë bashkëpunimi ka qenë?

Jusuf Osmani: Po ka pasë edhe serb, ka pasë edhe serb edhe në Arkiv të Prishtinës edhe në arkiv. Po nuk janë ekspozu. Ne kemi qenë shumë t'kujdesshëm. Se qëllimi ka qenë me mbrojtë dokumentacion, me sjellë dokumente. Nganjëherë reagojshin, po flas për vitet e '80-ta, "Çka po ju duhen kto dokumente?" Po nuk merrshin vesh shumë. Për shembull dokumentet e Lidhjes të Prizrenit, ish kjo koha kur ishte ni kohë liberalizimit t'marrdhënieve, jo liberalizim po pak nuk ish nacionalizmi. Filloj në '81-shin mas demonstratave. Vitet e '70-ta nuk ke pasë aq shumë.

Na prej '74-tes kemi ni ekspozion të zhvillimit arsimor, kulturor por edhe ekonomik. Mandej '81-shi me demonstrata fillun gradualisht, kinse serbët po shpërngulen me dhunë, p'e lshojnë Kosovën e kshtu. Ju s'i mbani mend kto. U dashtë me qenë i kujdesshëm. Me punu, m'i realizu qëllimet por mos me u ekspozu shumë. Kshtuqë marrëdhëniet në grup, bile për Lidhje të Prizrenit ni serb e kemi pasë të muzeut, nifar' Gordana Popoviç. Se për me t'pranue shteti ka qenë, u dashtë me qenë multi-nacional, jo veç shqiptar. Po e patëm fut edhe atë far' Gordanën. Ajo fort s'u përzike na i kryjshim detyrat tona.

U hap ekspozita. Në Beograd m'u hapë ekspozita për Lidhjen e Prizrenit nuk ka qenë lehtë. '79-ten u konë pasë hapë, '78-ten në Sarajevë u hap. Sarajeva e kërkun. Në Beograd në arkiv edhe kur ia paraqitshim hartën ku u shtri Vilajeti i Kosovës... se Lidhja e Prizrenit ka kërku bashkimin e katër vilajeteve. Të Kosovës, Manastirit, Shkodrës edhe të Jahninës. Edhe m'i ka pasë vizatu bukur Shyqri Nimani, ato hartat, i ndjeri. Po ishte atmosferë e tillë. Mandej unë isha magjistër shkence, isha i pregatitun dhe ju përgjigjsha atyne. Çdo gja që duhet me shiku në kontekst të kohës.

Anita Susuri: E n'vitin '90 a ka qenë kur jeni largu edhe ju prej punës?

Jusuf Osmani: Jo, unë kom qenë në Arkiv të Prishtinës atëherë. Atëherë s'ka qenë në masa të dhunshme. M'kanë largu prej drejtorit ndërsa kolektivi ka mbetë, asnjë... s'ka pasë masa t'dhunshme, s'ka pasë vendim, s'ka pasë nënshkrim edhe shkum te i ndjeri Pajazit Nushi, "A me u largu, me lshu arkivin", e Prishtinës po flas. Se drejtor s'lejshin, as shefa as hiç. Tha, "Jo, rrini rune dokumentacionin. Mos ua leni n'dorë serbëve se ata mandej manipulojnë".

Në Arkiv të Kosovës ka pasë masa po unë në '87-ten kom shku në Arkiv të Prishtinës. Deri në '89-ten kom qenë drejtor, më hiqën edhe mbetëm krejt kolektivi i pa prekun. Kemi rujtë dokumenacionin. Ajo ka qenë meritë e kolegëve. Serbët punonin po nuk guxonin se na i dishim. Ata s'kanë qenë fort t'informum çka ka. Na i rujtëm edhe pat' mbetë arkivi komplet.

Anita Susuri: Qysh ka qenë me punu n'qato vite?

Jusuf Osmani: Po nuk ka qenë lehtë, shumë vështirë ka qenë. Sepse ma së pari çasja me institucione ka qenë krejt në dur të serbëve, edhe në Arkivin e Prishtinës edhe Arkivi i Kosovës. Por, u dashtë me punu por mos m'u ekspozu shumë. Se meniherë ose të etiketojshin, të burgosshin ose n'forma tjera. Unë kom qenë n'sy bile '99-ten kanë ardhë edhe ktu edhe atje me m'kërku me m'likfidu si t'vetmin ekspert po pata ikë në Shkup, fati. Mandej kur erdha ministria më zgjodhi meniherë drejtor. Se kom kontribu edhe kërkoshin kuadra.

Anita Susuri: Kur jeni largu ju para bombardimeve apo?

Jusuf Osmani: Jo, mas bombardimeve.

Anita Susuri: Qysh ka qenë kjo?

Jusuf Osmani: Po unë isha n'banesë vllaznit ishin ktu. Komunikojsim me telefona dikur edhe telefonat... mandej krejt katuni kalun n'mal. Na deri me, me 1 prill kom qenë në Prishtinë. Me 2 prill ma kanë djegë shpijen, me 3 prill. Jom ikë në Shkup. Në Shkup kom nejt kom marrë ni banesë me qira erdhën djemt prej Londres, nuk kom shku nëpër fshatra. Pse? Se unë tre muj kom punu në arkiv edhe në bibliotekë. Kom bo hulumtime.

Bile kanë qenë në arkiv veç dy shqiptarë. Njana ka qenë, ka pasë babën si udhëheqës edhe kanë reagu, "Pse po vjen ky në arkiv çdo ditë?" Kanë thanë, "Arkivist", kanë thanë, "Bash që osht' arkivist, s'ka nevojë me ardhë". I kundërvihet ajo shqiptarja se s'guxojshin prej saj fort, e ka pasë babën si udhëheqës me maqedon edhe pata vazhdu. Në bibliotekë punojsha për vendbanimet edhe pata shfrytëzu kohën krejt, tre muj sa kom qenë. Se me shku n'fshat, kisha kushte materiale edhe e shfrytëzova.

Bile në bibliotekë fotokopjojsa. Ai që fotokopjojsa i lejsha nga pak pare. Ni euro me ia lanë, jo euro atëherë marka ka qenë, marka. Ai, jo formë korruptimi po qarrosje edhe m'jepshin material. Libra t'vjetra. Aty në arkiv hulumtojsa do dokumente por ato me kujdes se ish situata e tillë. Domethonë ku kom qenë kom shfrytëzu kom punu. Nuk do t'kisha arritë mos t'kisha punu, nuk kisha arritë unë m'i pasë t'gjitha kto vepra.

Anita Susuri: E që thatë keni shku në Shkup, a keni shku me autobus a me veturë? Si keni arritë me shku deri në Shkup? Se ka pasë edhe punkte.

Jusuf Osmani: Qysh a? Boll mirë ke pytë. Unë e kom pasë nanën e smut edhe u ndala në banesë. Thojsha, s'më prekë kërkush mu. Shojja me djalë edhe me ni djalë t'vllaut nisen për Shkup. Shtatë

ditë rrijnë në kufi. Shtatë ditë edhe i kthejnë. Vjen në Prishtinë thom, “Çka u bo?” Thotë, “Na kthyn”. T’nesrit n’mëngjes nëpër tankse, nëpër kto unë me veturë temën, ai me veturë t’vet. Unë nanën edhe shoqen po gruja e pinte duhanin.

N’punktin e parë në Ferizaj po ma bon me hi n’qytet me na likfidu. I kom nxjerrë 100 marka thom, “E kom nanën smutë po frikësohet p’e çoj në Shkup”. E ka kqyrë shokun e vet a po kqyrë, i ka marrë i ka shti n’xhep tha, “Vazhdoni”. Kur jom shku në Kaçanik ushtarë kishin qenë na nalën. Ata ishin kanë për cigare në zor “*Imate cigare*, a keni cigare?” “Po”. Gruja kish pasë ble nja gjysë boksi ia dha. “Vazhdoni”. Shkum në kufi.

Në kufi djali i vllaut dul me fmi t’mi e me shoqe n’kamë e la veturën, unë meta. Se nana s’munte, smutë. Thashë m’u kthy. Por fati e kanë çelë kufinin bash atë ditë kur u hap Bllaca edhe kufini nja 50 vetura kanë qenë, unë kalova. Grujen e fminë i kom gjetë në Stankovec. U kanë ni kamp i përqendrimit, p’e quj përqendrimi. Mas ni jave i kom nxjerrë. Ai djali i vllaut shkoj, e çun në Poloni. Unë e mora shoqen e nanën tre muj në Shkup.

Me përshkru vujtjet e kto, po shumë është gjetunia. Me kanë naj qyqan edhe gjuhen, gjuhen. “Pse po ikë?” Thashë, “Po nana, frikë, fmija”. Pak u dufke me dhanë edhe qishtu. Ktu tani m’kanë kërku, mas dy dite janë shku tani m’kanë kërku në banesë.

Anita Susuri: Si e keni kuptu? Ju kanë tregu?

Jusuf Osmani: E qe tash. Kur u ktheva, jom kthy meniherë masi janë hy trupat e NATO-s. Kur jom hy ka qenë me 12 kanë hy, a kur kanë hy? Unë me 15 kom qenë në Prishtinë. Kur kom shku ende banorë serb që ma kishin thy banesën, aty. U sillshin. Ka qenë ato, nja dy gra shqiptare edhe një katolik, ksi një katolik e ka pasë grujen kroate, Elzen. Tha, “Jusuf, mos flej ktu”, tha, “shko dikund se t’kanë lypë” tha, “vijnë natën, hala”, tha, “osht’ situata jo e mirë”.

E kisha motrën unë që ishim kthy bashkë në Breg të Diellit. Kom shku. Pesë ditë kom bujt te motra. Jom shku e kom marrë KFOR-in edhe jom hi n’banesë se lejshin bomba. Krejt ma kishin demolu. Ni gru e pashë që ma kish, i kish plaqkit dhomën e rrobat e shoqes, e kish ngarku ni kamion mobile, rroba e kish çu në Serbi. Thashë, “Çka ke bo?” “Jo unë kshtu”. Deri u stabilizu nuk kom guxu n’banesë. E ajo m’ka tregu, ajo kroatja.

Tha, “Erdh njani me regjistër”, tha, “p’e lypë Jusuf Osmanin”, tha, “i kom thanë *u Slatinu*, në Sllatinë”. Ai tha, “E pamundur, e pamundur osht” edhe tha, “u kthy”. T’nesrit janë ardhë e kanë thy banesën tem, krejt e demolune, u djegë. Se u digjshin edhe banesat tjera. Janë ardhë në Sllatinë ktu. Njënin e kanë taku ish ardhë me marrë traktorin se krejt n’katun. E vesin ata, ku janë filani, për mu. Thojnë, “Në Prishtinë”, tha, “E dredhoj krytë edhe u kthy”. Qishtu u kanë.

Anita Susuri: Veç ni pyetje e kom shumë interesante për juve se jeni marrë me hulumtimin e mbiemrave.

Jusuf Osmani: Po.

Anita Susuri: Po qysh dul Osmani mbiemri juj? A e keni pasë a e keni marrë ma vonë?

Jusuf Osmani: Qe qysh dul...

Anita Susuri: Po mendoj historiku.

Jusuf Osmani: Jo kjo kurgjo s'osht'. Që m'the, mandej kaloj te emri. N'viti 2000 qeveria e përkohshme ka qenë e Kosovës edhe UNMIK-u. Formohet ni komision për m'i ndrru emrat e vendbanimeve, m'i ndrru emrat. Unë isha sekretar i komisionit edhe ia ndrrum emrat. Për shembull, te Prizreni osht' ni Lutogllavë, ia ndrrum Lutogllavës Legjendë ia bom. Osht' nifar' Novoshumadija u kanë, ia bam Pusjat, vendbanim i vjetër. Ia ndrrum ksaj, ato katuneve që kanë qenë sllave, i bom shqip krejt. Se serbët kanë vepru. Por UNMIK-u na... edhe i botum, pesë vjet patëm punu.

E kshtu te mbiemrat i pari im ka ardhë, katragjyshi e ka pasë emrin Osman. Kur janë nisë, kur janë dëbu prej Sanxhakut të Nishit ka qenë baba i tij Nezir edhe janë qujtë Neziroviç, domethonë viç. Kanë mbajtë atë mbiemër Neziroviç. Në '47-ten, 1947 bohet regjistrimi jo i popullsisë po i emrave nëpër zyre t'vendit. "Qysh po e merrni mbiemrin?" Baba i babgjyshit tem e ka pasë emrin Osman po regjistrimet, kto na dojna, ai regjistrusi ka qenë serb. Dojmë m'i regjistru mbiemrat e katuneve atje, katuneve që kena pasë. Kojqiç, Merlak, Tmavë. Prej atyne katuneve që janë ktu. Nuk len ai serbi. Katuni i afërt, Bardh, Ballaqefc ka qenë ofiçari shqiptarë. Ai krejt i regjistron n'bazë të mbiemrave, Bajçinca, Simnica, Tmava, ksi, katune tjera, Bajçinovci. Krejt emra të atyne katuneve.

Anita Susuri: Që janë t'ardhun.

Jusuf Osmani: Po, që janë t'ardhun. Neve në emër të katragjyshit e kanë marrë këtë. Po jo veç na po e kanë marrë edhe do tjerë Osmani. Ky Rexhep Osmani ish ministri, e do tjerë e kanë mbiemrin Osmani. Se edhe ai i tyne ka qenë Osmani veç tjetër. Do kusheri janë tre kirurg tash e kanë ordinancën e vet Kojqiçi, aty. Janë shumë të suksesshëm kardiolog. Ata e kanë bo n'bazë t'katunit që janë ardhë. Po kjo osht' Osman prej emër musliman, e ka mbetë.